



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr.519 Akti

Nr.602 Vendimi

Tiranë, më 19.12.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja	Kryesuese
Alma Faskaj	Relatore
Suela Zhegu	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 16.12.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Olkeda Lice¹**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

¹Subjekti është e divorcuar, por në kohën e dorëzimit të deklaratës *Vetting* dhe gjatë periudhës së rivlerësimit ka qenë e martuar dhe ka pasur mbiemrin Manellari. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për zgjidhjen e martesës, ka datën 7.6.2017 (nr. vendimi ***) dhe ka marrë formë të prerë pasi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 19.6.2018. Pas zgjidhjes së martesës, subjekti ka rimarrë mbiemrin e vajzërisë Lice. Duke pasur parasysh periudhën e rivlerësimit, dokumentacionin e marrë në shqyrtim, ku subjekti paraqitet me mbiemër Manellari dhe karrierën e mëpasshme profesionale të saj, nga ana e Komisionit në këtë vendim, në parashtrimin e fakteve dhe në arsyetimin, janë përdorur të dy mbiemrat.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Alma Faskaj, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Olkeda Lice (Manellari), me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.6.2020, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

2. Në përfundim të shortit rezultoi se subjekti i rivlerësimit Olkeda Lice (Manellari) do të shqyrtohet nga trupi gjykues, i cili përbëhet nga komisionerët Alma Faskaj relatore, Etleda Çiftja kryesuese dhe Suela Zhegu anëtare.

3. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor.

4. Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka kryer kontroll të plotë së pasurisë së subjektit të rivlerësimit Olkeda Lice (Manellari), duke krahasuar “Deklaratën e pasurisë të rivlerësimit kalimtar *Vetting*” me deklaratat e pasurisë në vite dhe dokumentacionin justifikues bankar dhe jobankar etj., të dorëzuar nga subjekti me të dhënat e kërkuara me anë të korrespondencës pranë institucioneve publike. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja, për subjektin e rivlerësimit Olkeda Lice (Manellari), ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*

➤ *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

5. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

6. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Olkeda TH. Manellari (deklasifikuar plotësisht me vendimin nr.***, datë 5.2.2021, të KDZH-së), në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Olkeda TH. Manellari.

7. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

8. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 1, datë 22.6.2020, të trupit gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, për të tria kriteret bazuar në pikën 1 të nenit 4 të po këtij ligji, përkatësisht: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesuese e trupit gjykues komisionere Etleda Çiftja. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

9. Në datën 5.12.2022, trupi gjykues, me vendimin nr. 2, vendosi të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit Olkeda Lice (Manellari), bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes.

10. Në datën 6.12.2022, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, duke i kaluar barrën e provës për sa ka rezultuar nga hetimi dhe duke i dhënë të drejtën të njihet me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe të paraqesë shpjegime/prova shtesë brenda datës 15.12.2022, ora 09:00.

11. Në datën 7.12.2022 subjekti i rivlerësimit u njoh me materialet e dosjes.

12. Në datën 14.12.2022 subjekti i rivlerësimit dërgoi në rrugë elektronike (me *email*) shpjegimet e saj mbi rezultatet e hetimit kryesisht, të shoqëruara me dokumentacion dhe në datën 15.12.2022, brenda afatit të caktuar, i depozitoi fizikisht pranë Komisionit².

13. Në datën 14.12.2022, me vendimin nr. 3, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Olkeda Lice (Manellari) në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit

²Nr. *** prot., datë 15.12.2022.

nr. 84/2016 dhe me anë të postës elektronike e njoftoi se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 16.12.2022, në orën 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

14. Në datën 16.12.2022 u zhvillua seanca dëgjimore, ku subjekti i rivlerësimit ishte e pranishme.

II. SEANCA DËGJIMORE

15. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit Olkeda Lice (Manellari) u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs.

16. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit Olkeda Lice (Manellari) shprehu qëndrimin e saj lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni.

17. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

18. Znj. Olkeda Lice ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit ndaj saj, duke u përgjigjur dhe duke dërguar dokumentacionin dhe shpjegimet përkatëse sipas kërkesës së Komisionit, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

19. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

20. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

21. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

22. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

23. Në kreun VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

24. Por, referuar vendimit nr. 2/20171 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

25. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkrese të administruara nga ILDKPKI-ja, që gjenden në dosjen e subjektit dërguar në Komision; (d) provat shkrese/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

26. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u vijua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së subjektit dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj.

27. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës *Vetting*, të paraqitur më parë te ky institucion, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Olkeda Lice (Manellari).

28. Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

29. Subjekti i rivlerësimit aktualisht është e divorcuar dhe ka një fëmijë të mitur, por në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* ka qenë e martuar.

30. Procesi i rivlerësimit për komponentin e pasurisë nga Komisioni është bazuar në: (i) pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur; (ii) pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratat vjetore të pasurisë për vitet 2011 – 2016 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat

e lidhur; (iii) hetimin e pasurive të personave të tjerë të lidhur; si dhe (iv) dokumentacionin e administruar nga hetimi administrativ.

31. Subjekti i rivlerësimit Olkeda Lice (Manellari) e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë *Vetting* (duke përfshirë personat e lidhur) në datën 30.1.2017, në bazë të ligjit nr. 84/2016, fakt ky i konfirmuar nga ILDKPKI-ja nëpërmjet vërtetimit të lëshuar. Pra, subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi.

32. Subjekti i rivlerësimit Olkeda Lice (Manellari) ka ushtruar këto detyra: (a) për vitet 2009 – 2012 ka kryer Shkollën e Magjistraturës; (b) me Dekretin nr. ***, datë 10.11.2011, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë është emëruar për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë; (c) nga data 23.1.2014 e në vijim është gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

33. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë deklaruar këto pasuri dhe likuiditete:

A/1. Deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting*

i. Pasuritë e deklaruara nga subjekti në deklaratën *Vetting*

34. Gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, pjesë e mbetur pas tërheqjes së depozitës bankare me afat pranë Bankës Kombëtare Tregtare, hapur në datën 27.4.2016 dhe mbyllur më 10.1.2017.

Burimi i krijimit: kursime nga të ardhurat familjare.

Vlera: 1.400.000 lekë. Pjesa takuese: 50%.

Hetimi/analiza ligjore financiare e kryer nga Komisioni

34.1 Depozita bankare për të cilën subjekti deklaron se nga tërheqja e saj i ka mbetur vlera *cash* e deklaruar në deklaratën *Vetting*, është hapur në BKT në datën 27.4.2016³. Kontrata e depozitës bankare është dyemërore, në emër të G.M ose Olkeda Manellari.

Subjekti dhe personi i lidhur G.M e kanë deklaruar atë në DIPP/2016 në vlerën 1.800.000 lekë, me burim kursimet e krijuara nga të ardhurat familjare ndër vite dhe pjesa takuese e secilit është deklaruar 50%.

34.2 Në datën e hapjes së depozitës, personi i lidhur i subjektit, z. G.M, ka derdhur *cash* vlerën 1.818.000 lekë dhe ka çelur depozitë kursimi me afat 1 vit. Burimi i vlerës së derdhur është deklaruar “paga dhe kursime” dhe në datën 9.12.2017, para afatit të maturimit, z. G.M ka tërhequr nga llogaria vlerën 1.818.000 lekë. Deklarata *Vetting* është plotësuar në datën 30.1.2017.

34.3 Subjekti gjatë procesit ka sqaruar⁴ se depozita është tërhequr nga z. G.M pa dijeninë e saj në një kohë kur marrëdhënia e tyre ishte konfliktuale dhe se kur është plotësuar

³Shkresë nr. *** prot., datë 15.12.2020, e BKT-së.

⁴Pyetësorët nr. 1 dhe nr. 2.

deklarata *Vetting*, po në kushtet e një marrëdhënieje konfliktuale, i është thënë prej bashkëshortit që vlera që kishte mbetur nga shuma e tërhequr ishte 1.400.000 lekë, ndaj ka deklaruar këtë vlerë, me pjesë takuese 50%.

34.4 Referuar deklaramit të z. G.M në momentin e hapjes së depozitës, por edhe deklaramit të subjektit në deklaratën *Vetting* dhe në DIPP/2016, ku deklaroi si burim të depozitës kursimet nga të ardhurat familjare ndër vite, Komisioni vëren se si burim i depozitës është përdorur gjendja e akumuluar e kursimeve *cash*, e cila deri në fund të vitit 2015 për të dy bashkëshortët është 840.000 lekë.

34.5 Në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të depozitës së kursimit, Komisioni hartoi analizën financiare për periudhën janar 2016 deri në datën e hapjes së depozitës (27.4.2016), si vijon:

Analiza financiare	Periudha 1.1.2016 – 27 .4.2016 (në lekë)
Të ardhura nga paga si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe leje lindjeje	167 841
Të ardhura nga paga si k/specialist pranë “***” sh.a.	338 132
Shpenzime jetese	156 728
Shpenzime udhëtimesh	42 440
Ndryshimi i gjendjeve të likuiditeteve	-90 368
Shpenzime qiraje	60 000
Rezultati financiar	337 172
<i>Gjendja e kursimeve cash në fund të vitit 2015</i>	<i>840 000</i>
<i>Derdhja cash për depozitën</i>	<i>1 818 000</i>
Pamundësia financiare	-640 828

Nga kjo analizë rezultoi se:

- Subjekti dhe personi i lidhur G.M kanë pasur pamundësi financiare në vlerën 640.828 lekë për krijimin e depozitës së kursimit me të ardhura të ligjshme.
- Duket se subjekti ka pasaktësi në deklaram, pasi nuk ka deklaruar se si është shpenzuar diferenca e vlerës së depozitës (1.818.100 lekë) me vlerën e kursimeve *cash* (1.400.000 lekë) të deklaruara me burim këtë depozitë.

34.6 Me dërgimin e rezultateve të hetimit sipas pikës 2 të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e hetimit në lidhje me pamundësinë financiare për krijimin e depozitës me të ardhura të ligjshme, si dhe lidhur me pasaktësinë në deklaram, sa i përket mënyrës së shpenzimit të diferencës së depozitës me vlerën e kursimeve *cash* me burim këtë depozitë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

34.7 Pas dërgimit të rezultateve të hetimit me të cilat iu kalua barra e provës, subjekti depozitoi në Komision shpjegime të shoqëruara me dokumentacion.

34.7.1 Ajo shpjegoi se për shkak të situatës së saj konfliktuale me bashkëshortin, analiza financiare për mundësinë e krijimit të depozitës duhej të kryhej vetëm për një person dhe kontributi i saj duhej të analizohej vetëm për gjysmën e vlerës së depozitës ose për vlerën 909.000 lekë, pra pa përfshirë kontributin e personit të lidhur. Subjekti përcolli në Komision analizën financiare për mundësinë e krijimit të depozitës të hartuar sipas parashtrimeve të saj për periudhën janar - prill 2016, të cilat përfshijnë edhe trajtimin e disa vlerave në llogaritjet e analizës së Komisionit, nga ku rezultati i saj është me vlerë negative 69.364 lekë.

34.7.2 Në vijim, subjekti shpjegoi marrëdhënien konfliktuale me personin e lidhur, z. G.M, e cila ka qenë faktor për mospasjen e një komunikimi normal me të. Gjithashtu ka shpjeguar se në deklaratën *Vetting* ka deklaruar të dhënat sipas informacioneve të marra nga ish-bashkëshorti dhe se në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* ka qenë në pozita të disfavorshme, pasi ishte ajo personi që rrezikonte karrierën në rast të mosplotësimit në kohë të deklaratës, ndërsa depozita ishte tërhequr prej z. G.M pak ditë para plotësimit të deklaratës dhe gjendja e saj mbahej *cash* prej tij. Duke mos pasur mundësinë e verifikimit të vlerës së saktë dhe duke konsideruar se pak ditë e ndanin nga dorëzimi i deklaratës *Vetting*, e ka plotësuar deklaratën vetëm mbi informacionin e marrë verbalisht prej ish-bashkëshortit, pasi nuk mund të rrezikonte tejkalimin e afatit për dorëzimin e saj, e cila do të rrishte edhe karrierën e saj. Subjekti i qëndroi shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit se nuk kishte dijeni se si ishte shpenzuar nga ish-bashkëshorti diferenca e vlerës së depozitës së kursimit me kursimet *cash* të deklaruara në deklaratën *Vetting* dhe se kjo ishte përgjegjësia dhe detyrimi i tij ligjor.

34.8 Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 16.12.2022, subjekti mbajti të njëjtin qëndrim dhe parashtroi të njëjtat shpjegime me ato të parashtruara me prapësimet e paraqitura me shkrim.

34.8.1 Subjekti shpjegoi se depozita në fjalë është e vetmja pasuri bashkëshortore në të cilën ajo zotëronte 50%, e hapur pak ditë para lindjes së fëmijës së tyre, për t'i siguruar një burim të sigurt financiar.

34.8.2 Lidhur me pjesën takuese të personit të lidhur (ish-bashkëshortit), parashtroi se të ardhurat e tij nga bastet sportive kanë qenë të ligjshme dhe se përgjegjësia për deklarimin e shumës i takonte atij.

Vlerësimi i Komisionit

34.9 Në analizë të provave të administruara dhe shpjegimeve, trupi gjykues vlerësoi se pavarësisht nga marrëdhënia konfliktuale me bashkëshortin, me të cilin ka zgjidhur martesën në qershor të vitit 2017 (vendim i cili ka marrë formë të prerë në qershor të vitit 2018), gjatë periudhës së rivlerësimit ish-bashkëshorti ka qenë person i lidhur me subjektin

dhe bazuar në pikën 13 të nenit 3⁵ dhe në nenin 30⁶ të ligjit nr. 84/2016, analiza financiare duhet të përfshijë edhe personin e lidhur, sipas përcaktimeve ligjore.

34.10 Në analizë të provave të administruara dhe shpjegimeve të paraqitura, trupi gjykues çmon se subjekti nuk arriti të provonte se konfliktet e saj kanë ndikuar në shpenzimet e kryera, për pasojë trupi gjykues çmon se nuk mund të ndryshohet metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare.

34.11 Në lidhje me vlerën e të ardhurave nga paga e subjektit të rivlerësimit u vlerësua se shuma totale e llogaritur nga Komisioni prej 167.841 lekësh duhet të përditësohet duke përfshirë edhe vlerën e pagës të muajit dhjetor të vitit 2015, e cila është transferuar në llogarinë e subjektit në janar të vitit 2016. Pas këtij ndryshimi, vlera totale e të ardhurave të saj është 255.096 lekë dhe rezultati i analizës financiare është me pamundësi në vlerën 553.573 lekë.

ii. Të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*

35. Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës, të ardhura nga paga *neto* si gjyqtare, të ardhura nga trajnime, si dhe të ardhura të krijuara nga bashkëshorti nga puna e tij në shoqërinë “****” dhe bastet sportive. Të ardhurat e subjektit, të deklaruara prej bashkëshortit, janë në vlerën totale 5.667.565 lekë.

Hetimi/analiza ligjore financiare e kryer nga Komisioni

35.1 Komisioni mori informacion zyrtar nga institucionet në lidhje me të ardhurat e subjektit të rivlerësimit⁷ dhe shuma totale e të ardhurave të përfshira në analizën financiare është 5.000.426 lekë. Mospërputhja vjen kryesisht prej deklaramit nga subjekti i rivlerësimit të vlerës së bursës nga Shkolla e Magjistraturës të përfituar përpara periudhës së deklaramit (datë 10.11.2011).

35.2 Vlera totale e të ardhurave të personit të lidhur, z. G.M, të përfshira në analizën financiare është 2.462.726 lekë, që burojnë nga marrëdhënia e tij e punësimit, ndërsa të ardhurat e deklaruara nga bastet sportive nuk janë përfshirë/konsideruar në analizën financiare, pasi nuk është arritur të provohet ligjshmëria e tyre, si dhe nuk janë deklaruar shpenzimet e kryera prej tij për të përfituar këto të ardhura dhe shpenzimet e tjera për efekt të kësaj veprimtarie.

⁵“Person i lidhur” është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, ..., i përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerësimit, ... për periudhën e rivlerësimit”.

⁶ “Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij”.

⁷Vërtetim nr. *** prot., datë 18.12.2020, i DPT-së; vërtetim nr. *** prot., datë 11.12.2020, i ISSH-së dhe leje lindjeje sipas vërtetimit datë 9.1.2017, të ISSH-së, në aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

Vlerësimi i Komisionit

35.3 Në analizë të provave të administruara dhe shpjegimeve, trupi gjykues çmoi se nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë deklaram të subjektit të rivlerësimit në kuadër të procesit të rivlerësimit.

A/2. Deklarimi i personit të lidhur të subjektit/bashkëjetuesit në deklaratën *Vetting*

iii. Pasuri të deklaruara nga personi i lidhur i subjektit në deklaratën *Vetting*

36. Banesë me sipërfaqe 72 m², në rrugën “**”, dhuruar në vitin 2014**

Burimi i krijimit: kontratë nr. ***, datë 25.7.2014, “Për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve të kontratës me nr. ***, datë 18.10.2007”, pa shpërbllim dhe kontratë shitblerjeje pasurie e paluajtshme nr. ***, datë 12.9.2014, me blerëse shtetasen P.XH, të cilët kanë likuiduar vlerën e çmimit të apartamentit 43.200 euro, me këste, në tetor të vitit 2007. Vlera: 0 (zero) lekë. Pjesa takuese: 100%.

Hetimi/analiza ligjore financiare i/e kryer nga Komisioni

36.1 Kjo pasuri është fituar nga nëna e personit të lidhur të subjektit, znj. P.M (porositësi), në bazë të një kontrate sipërmarrjeje të lidhur me shoqërinë e ndërtimit “H” sh.p.k. në datën 10.8.2007⁸, sipas të cilës kjo shoqëri po ndërton për llogari të porositësit një apartament me sip. 72 m² në katin e tetë teknik, ose katin e nëntë banimi, në kompleksin që po ndërtonte në rrugën “****”, kundrejt vlerës 43.200 euro. Shlyerja e detyrimeve është bërë në dy këste po në vitin 2007⁹.

36.2 Në datën 25.7.2014 midis znj. P.XH (ndryshuar mbiemri nga M. në XH¹⁰) dhe z. G.M është lidhur kontratë¹¹ për transferim të të drejtave dhe detyrimeve të kontratës së sipërpërmendur të sipërmarrjes. Me këtë kontratë znj. P.XH, me pëlqimin e bashkëshortit L.M dhe me miratimin paraprak të shoqërisë ndërtimore “H” sh.p.k.¹², i ka kaluar të birit G.M, pa shpërbllim, të drejtën e fituar me kontratën e sipërmarrjes si më lart, të lidhur në vitin 2007 dhe i japin atij të drejtën që të nënshkruajë kontratën përfundimtare të shitjes së apartamentit. Gjithashtu, në këtë kontratë janë shprehur se pranojnë që vlera e paguar prej tyre për blerjen e apartamentit në fjalë të konsiderohet vlerë e likuiduar në favor të shoqërisë “H” sh.p.k. nga djali i tyre G.M.

36.3 Në vijim, z. G.M ka lidhur me shoqërinë ndërtimore “H” sh.p.k. kontratën për blerjen e këtij apartamenti¹³ dhe e ka regjistruar atë në pronësi 100% të tij. Sipas kësaj kontrate, çmimi i shitjes është 43.200 euro dhe është likuiduar ndërmjet palëve në përmbushje të kushteve të kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 18.10.2007 (kontrata e sipërpërmendur).

⁸Për këtë kontratë jonoteriale janë vërtetuar nënshkrimet e palëve nga noterja M.LL me akt noterial nr. ***, datë 18.10.2007.

⁹Neni 3 i kontratës dhe shkresa e shoqërisë “H” sh.p.k., administruar në Komision me nr. *** prot., datë 19.4.2022.

¹⁰Sipas procesverbalit nr. ***, datë 5.5.2008, shpjeguar nga noteri në kontratë.

¹¹Kontratë nr. ***, datë 25.7.2014, noter E.B.

¹²Deklaratë noteriale nr. ***, datë 25.7.2014, notere M.LL.

¹³Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 12.9.2014, notere M.LL.

36.4 Personi i lidhur, z. G.M, në DIPP/2014 e ka deklaruar këtë apartament të fituar me kontratat e sipërpërmendura, si 100% në pronësi të tij dhe në datën 7.4.2018 e ka shitur atë¹⁴.

36.5 Pavarësisht se në kohën e lidhjes së kontratës së shitblerjes dhe regjistrimit të pasurisë subjekti dhe personi i lidhur, z. G.M, ishin të martuar dhe i nënshtroheshin regjimit pasuror të bashkësisë ligjore, pasuria është regjistruar në pronësi 100% të tij. I pyetur nga Komisioni¹⁵ në lidhje me këtë fakt dhe nëse subjekti ka përfituar pjesë nga vlera e shitjes së kësaj pasurie nga ish-bashkëshorti, subjekti sqaroi se ajo (pasuria) është konsideruar pasuri vetjake e ish-bashkëshortit, e fituar gjatë martesës me anë të dhurimit. Si e tillë, është trajtuar në përputhje me nenin 77, germa “b” e Kodit të Familjes, ku parashikohet se: *“Pasuri vetjake e bashkëshortit që nuk bën pjesë në bashkësi është a) [...], b) pasuria e fituar gjatë martesës me anë të dhurimit, të trashëgimisë ose legut, kur në aktin e dhurimit ose në testament nuk përcaktohet se ato janë dhënë në favor të bashkësisë”*. Gjithashtu, subjekti sqaroi se meqenëse nuk ka kontribuar në krijimin e saj, nuk ka pasur pretendime në lidhje me këtë çështje.

36.6 Komisioni hetoi në lidhje me konfliktin e interesit dhe nuk rezultoi që subjekti, gjatë kohës së ushtrimit të detyrës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, të ketë shqyrtuar çështje me palë ndërgjyqëse “H” sh.p.k. dhe/ose administratorët e saj¹⁶.

36.7 Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë, Komisioni hartoi analizën financiare për të hetuar mundësinë financiare të znj. P.M (Xh) dhe z. L.M për të blerë këtë pasuri. Nga analiza rezultoi se familja prindërore e z. G.M nuk ka pasur mundësi të shlyejë pagesat për blerjen e apartamentit me të ardhura të ligjshme, duke rezultuar me pamundësi në vlerën 647.790 lekë.

Vlerësimi i Komisionit

36.8 Në analizë të provave të administruara dhe shpjegimeve, trupi gjykues konstatoi se pagesat për blerjen e apartamentit janë kryer përpara lidhjes së martesës së subjektit të rivlerësimit me z. G.M. Trupi gjykues vlerësoi kjo pasuri është krijuar nga personat e tjerë të lidhur (prindërit e bashkëshortit) para martesës së subjektit dhe nuk ka të dhëna që subjekti ka kontribuar në krijimin e saj.

37. Apartament banimi me sipërfaqe totale 63 m², në Pogradec, pronë e përfituar nga privatizimi i banesave me kontratë datë 17.6.1993 ndërmjet NKBanesa dhe qiramarrësit L.M. Vlera: 26.875 lekë. Pjesa takuese: 20%.

Hetimi/analiza ligjore financiare e kryer nga Komisioni

¹⁴Kontratë shitjeje nr. ***, datë 7.4.2018, noter E.B.

¹⁵Pyetësor nr. 2.

¹⁶Përkatesisht shkresat nr. *** prot., datë 1.4.2022 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 1.4.2022) dhe nr. *** prot., datë 30.3.2022 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 1.4.2022).

37.1 Nga hetimi i Komisionit rezultoi se për këtë pasuri është lëshuar certifikata e pronësisë në datën 15.4.2008, në bashkëpronësi të personit të lidhur të subjektit dhe prindërve të tij. Pra, kjo pasuri ka qenë e regjistruar në bashkëpronësi të personit të lidhur para martesës së tij me subjektin dhe para se kjo e fundit të bëhej subjekt rivlerësimi.

Vlerësimi i Komisionit

37.2 Në analizë të provave të administruara dhe shpjegimeve, trupi gjykues konstatoi se përputhet deklarimi me dokumentacionin e përcjellë në Komision dhe nuk konstatohen problematika me pasurinë në lidhje me procesin e rivlerësimit.

38. Automjet tip “Ford WGR Galaxy”, me targa *, me kontratën datë 3.7.2015**

Burimi i krijimit: vlera e përfituar nga shitja e automjetit tip “Peugeot 2AK”, me targa ***, në datën 1.8.2015, i cili ishte blerë nga kursimet familjare me kontratën datë 27.11.2013.

Vlera: 3.000 euro. Pjesa takuese: 100%.

Hetimi/analiza ligjore financiare e kryer nga Komisioni

38.1 Automjeti është zhdoganuar në Durrës, ku importues është z. G.M, dhe është regjistruar në pronësi të tij në datën 3.8.2015¹⁷. Mjeti është blerë në vlerën 2.500 euro.

38.2 Para këtij automjeti, personi i lidhur i subjektit, z. G.M dhe subjekti kanë pasur në bashkëpronësi një automjet tip “Peugeot” me targa ***, të cilin e kanë blerë në datën 27.11.2013, në vlerën 150.000 lekë. Këtë automjet e kanë shitur në datën 1.8.2015 në vlerën 3.700 euro (vlera që deklarohet se është burim i automjetit tip “Ford”).

38.3 Mbi mundësinë financiare të subjektit dhe z. G.M për blerjen e automjetit tip “Peugeot”, me targa ***, u hartua analiza financiare si më poshtë, ku rezultoi se ata kanë pasur mundësi të blejnë automjetin me të ardhura të ligjshme.

Analiza financiare	Periudha 1.1.2013 – 27 .11.2013 (vlerat në lekë)
Të ardhura nga paga si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë	722 810
Vlera e blerjes së automjetit me targa ***	150 000
Shpenzime udhëtimi	39 008
Shpenzime jetese	258 544
Ndryshimi i gjendjeve të likuiditeteve	-90 965
Rezultati financiar	366 223

38.4 Rezulton se shitja e automjetit tip “Peugeot” me targa *** është bërë në datën 1.8.2015, ndërsa blerja e automjetit tjetër, për të cilin subjekti deklaroi se ka si burim shitjen e të parit, është bërë në datën 3.7.2015. Rrjedhimisht vlera e shitjes së mjetit të parë nuk mund të ketë shërbyer si burim për blerjen e mjetit tjetër dhe Komisioni në analizën

¹⁷Nga dosja e mjetit të vendosur në dispozicion nga DPSHTRR-ja me shkresën nr. ***, datë 14.12.2020 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 15.12.2020).

financiare të kryer nuk përfshiu si burim krijimi të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Peugeot”.

38.5 Në analizë të provave të administruara dhe shpjegimeve, trupi gjykues konstatoi se:

- vlera e shitjes së automjetit tip “Peugeot” rezulton shumë më e lartë se vlera e blerjes së tij;
- personi i lidhur i subjektit rezulton me pamundësi financiare në vlerën 3.000 euro për blerjen e automjetit tip “Ford”, pasi si burim ka deklaruar të ardhurat nga shitja e automjetit të mëparshëm tip “Peugeot” me targa ***, për të cilat kontrata e shitjes është lidhur pas kontratës së blerjes së automjetit tip “Ford” me targa ***.

38.6 Me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë shpjegime mbi diferencën e madhe midis çmimit të blerjes dhe atij të shitjes së automjetit si më lart.

38.6.1 Gjithashtu, sipas pikës 2 të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e hetimit lidhur me pamundësinë financiare.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

38.7 Pas dërgimit të rezultateve të hetimit me të cilat iu kërkuan shpjegime dhe iu kalua barra e provës, subjekti depozitoi në Komision shpjegime të shoqëruara me dokumentacion.

38.7.1 Subjekti shpjegoi se automjeti tip “Ford” ka qenë në pronësi të personit të lidhur, z. G.M, dhe ajo nuk ka qenë asnjëherë zotëruese e tij dhe nuk ka përfituar interesa apo vlera monetare nga shitja e tij. Shpjegoi se në këto kushte të gjitha transaksionet financiare janë kryer nga ana e tij dhe bisedimet me shitësin dhe blerësin janë kryer vetëm prej tij, ndërsa ajo nuk ka qenë as pjesë e bisedimeve dhe as pjesëmarrëse në blerjen e automjetit.

38.7.2 Në vijim të këtyre shpjegimeve, subjekti ka parashtruar se vlera e shitjes së automjetit tip “Peugeot”: *“...në DIPP/2015 është deklaruar nga ana ime si e ardhur 50% për shkak të logjikës ligjore dhe moskuptimit drejt të plotësimit të rubrikave të deklaratës, por në fakt këto të ardhura në asnjë moment nuk janë marrë nga ana ime”*. Subjekti vijon shpjegimet se lidhja e saj me këtë automjet qëndron në momentin e formalizimit të marrëdhënies me blerësin, ku për efekt të ligjit kërkohet edhe nënshkrimi i saj dhe se me shitjen e automjetit është marrë vetëm ish-bashkëshorti; se ajo nuk ka njohuri për automjetet dhe vlerën e tyre në treg si dhe mirëmbajtjen mekanike dhe se shuma e shitjes nuk i është dhënë asaj dhe as në prezencë të saj.

38.7.3 Subjekti shpjegoi se nga ish-bashkëshorti në atë kohë i është thënë se në mjetin në bashkëpronësi ka kryer punime mekanike herë pas here, të cilat i kanë rritur vlerën në treg, por nuk i ka bërë me dije vlerën e këtyre shpenzimeve, as nuk i ka dhënë faturë dhe as nuk i ka deklaruar ato si shpenzime të deklarueshme në deklaratën periodike. Subjekti ka shpjeguar se: *“Nga shuma e shitjes së automjetit në bashkëpronësi unë nuk kam përfituar asnjë të ardhur, për shkak se mjetin objekt verifikimi e regjistroi vetëm në pronësi të vet...”*

dhe më pas e ka tjetërsuar në datën 20.8.2018 në vlerën 700.000 lekë edhe sërish edhe nga kjo vlerë unë nuk kam përfituar asnjë lek”.

38.7.4 Në lidhje me kohën e lidhjes së kontratës së shitblerjes për automjetin tip “Peugeot”, subjekti shpjegoi se në kuadër të bashkëpunimit me procesin ka kontaktuar nëpërmjet rrjeteve sociale me personin që ka blerë mjetin, i cili e ka sqaruar se blerjen faktike të tij e ka realizuar me ish-bashkëshortin përpara formalizimit të kontratës tek noteri dhe se duke qenë se ky shtetas ndodhet jashtë shtetit i ka dërguar nëpërmjet *email*-it një deklaratë dore me nënshkrimin e tij, të cilën subjekti e paraqiti pranë Komisionit së bashku me prapësimet. Në këtë deklaratë, blerësi i automjetit, z. G.T, ka deklaruar se blerja faktike e tij është bërë në korrik të vitit 2015, atëherë është bërë edhe pagesa, ndërsa nënshkrimi i kontratës para noterit është bërë rreth një muaj më vonë, për shkak të angazhimeve të tij të tjera në atë periudhë.

38.8 Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 16.12.2022, subjekti mbajti të njëjtin qëndrim dhe parashtrori të njëjtat shpjegime me ato të parashtruara me prapësimet e paraqitura me shkrim.

Vlerësimi i Komisionit

38.9 Në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe provave të administruara, trupi gjykues vlerësoi se marrëdhënia juridike e shitblerjes së automjetit tip “Peugeot”, ku palët kanë shprehur vullnetin për kryerjen e këtij veprimi, ka ndodhur *de facto* para formalizimit të kontratës së shitblerjes dhe pasojat faktike, duke përfshirë edhe kryerjen e pagesës nga ana e blerësit, kanë ardhur pikërisht në këtë kohë (korrik 2015). Ky veprim faktik i shitblerjes është formalizuar para noterit në gusht të vitit 2015, por subjekti nuk provoi faktin që diferenca e madhe midis çmimit të blerjes dhe atij të shitjes së automjetit tip “Peugeot” ka ardhur si pasojë e kryerjes së punimeve mekanike, të cilat i kanë rritur vlerën. Për këtë arsye, si burim krijimi i pasurisë automjet tip “Ford” u konsiderua vetëm vlera 150.000 lekë (vlera e blerjes së automjetit “Peugeot”).

38.10 Për sa më sipër, në mbështetje të metodologjisë së Komisionit, trupi gjykues vlerësoi se pamundësia financiare e personit të lidhur të subjektit është në vlerën 262.950 lekë.

38.11 Në përfundim, Komisioni çmoi që vlerësimin në lidhje me këtë gjetje ta bëjë në raport me tërësinë e vlerësimeve për pasuritë e tjera në vlerësimin përfundimtar të kriterit të pasurisë.

39. Gjendje cash jashtë sistemit bankar – pjesë e mbetur pas tërheqjes së depozitës bankare me afat pranë Bankës Kombëtare Tregtare, hapur në datën 27.4.2016, mbyllur më 10.1.2017.

Burimi i krijimit: kursime nga të ardhurat familjare.

Vlera: 1.400.000 lekë. Pjesa në përqindje: 50%.

Fakte nga hetimi administrativ kryesisht

39.1 Kjo pasuri e përbashkët u trajtua tek pasuritë e subjektit të rivlerësimit (pika 34/i e kreut A/1).

iv. Të ardhurat e deklaruara nga personi i lidhur i subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting*

40. Në deklaratën *Vetting* personi i lidhur i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga bastet sportive pranë kompanisë “****”, datë 12.11.2015 dhe datë 18.11.2015, si dhe të ardhura *neto* nga paga si kryespecialist pranë drejtorisë së privatizimit të shoqërisë tregtare “A” sh.a., Patos, nga data 9.8.2014 deri më 30.9.2016.

Hetimi/analiza ligjore financiare e kryer nga Komisioni

40.1 Bashkëlidhur deklaratës *Vetting* subjekti ka përcjellë si provë dy fotokopje të printimit të tërheqjes *cash* të shumës totale 410.000 lekë nga faqja e shërbimit @***.al nga useri ***, ku përshkruhen kontaktet (nr. i telefonit dhe *email*) e tërheqësit të vlerës dhe emri i tij, shtetasi G.M, si dhe vërtetim nga shoqëria “A” sh.a., datë 24.10.2016, ku deklarohet se shuma totale e fituar prej pagave të tij gjatë periudhës 9.8.2014 – 30.9.2016 ka qenë 2.515.877 lekë.

40.2 Komisioni mori informacion zyrtar nga institucionet¹⁸ në lidhje me të ardhurat e personit të lidhur, z. G.M, dhe përfshiu në analizën financiare vetëm të ardhurat nga punësimi pranë shoqërisë “A” sh.a., Patos, në vlerën 2.462.726 lekë. Në lidhje me të ardhurat e fituara nga bastet sportive, ato nuk u përfshinë/konsideruan në analizën financiare, pasi nuk u arrit të provohet ligjshmëria e tyre. Komisioni, duke u nisur edhe nga praktika e tij dhe e Kolegjit¹⁹, vërejti se subjekti nuk përcolli dokumentacion i cili provon marrjen e vlerës së deklaruar nga z. G.M, por edhe shlyerjen e detyrimeve tatimore mbi këto vlera.

40.3 Gjithashtu, Komisioni konstatoi se personi i lidhur i subjektit ka deklaruar të ardhura nga lojërat e fatit, por nuk ka deklaruar shpenzimet e kryera prej tij për të përfituar këto të ardhura dhe shpenzimet e tjera për efekt të kësaj veprimtarie, të cilat do të rrisnin balancën negative të analizës financiare të subjektit.

GJETJE TË TJERA

41. Subjekti aktualisht ka të regjistruar në DPSHTRR automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, të cilin e ka blerë në datën 4.12.2018 nga z. M.D kundrejt vlerës 370.000 lekë²⁰.

¹⁸Vërtetim nr. *** prot., datë 18.12.2020, i DPT-së; vërtetim nr. *** prot., datë 11.12.2020, i ISSH-së.

¹⁹Vendim nr. ***, datë 14.10.2019, i Kolegjit, subjekt A.S; vendim nr. ***, datë 10.9.2020, i Komisionit, subjekt A.G.

²⁰Shkresë nr. *** prot., datë 14.12.2020, e DPSHTRR-së (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 15.12.2020).

41.1 Komisioni hetoi mbi ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm interesi me këtë shtetas dhe rezultoi se subjekti nuk ka shqyrtuar ndonjë çështje gjyqësore ku të ketë qenë ky shtetas palë ndërgjyqëse²¹.

41.2 Nga analiza financiare e kryer lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie rezultoi se subjekti ka pasur mundësi të blejë automjetin e mësipërm me të ardhura të ligjshme.

42. Nga hetimi rezultoi se në vitet 2011 - 2012 (periudhë gjatë të cilës ushtronte detyrën²²) subjekti ka qenë në përbërje familjare me prindërit TH dhe ZH.L. Në pikën 13 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, përcaktohet se: *“Person i lidhur është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, i përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerësimit, për periudhën e rivlerësimit”*. Bazuar në këtë përcaktim që ligji bën për personat e lidhur, pavarësisht nga fakti se në deklaratën *Vetting* prindërit nuk kanë qenë në përbërjen familjare të subjektit, Komisioni ka hetuar për pasuritë e personave që kanë qenë pjesë e përbërjes familjare që në momentin e fillimit të periudhës së rivlerësimit. Nga ky hetim rezultoi si vijon:

42.1 Z. TH.L dhe znj. ZH.L (prindërit e subjektit) janë bashkëpronarë në dy apartamente të ndodhura në Korçë²³, me nr. pas. ***, z. k. ***, sip. 77 m² dhe nr. pas. ***, z. k. ***, sip. 130 m².

42.2 Apartamenti me nr. pasurie *** është fituar me kontratë privatizimi në vitin 1993 (kur subjekti ka qenë e mitur).

42.3 Apartamenti tjetër me sip. 130 m² është blerë nga prindërit e subjektit me kontratën e shitblerjes të lidhur në datën 13.4.2018²⁴ në vlerën 5.000.000 lekë, ndërsa aktmarrëveshja paraprake me shoqërinë e ndërtimit në lidhje me këtë apartament është lidhur në datën 12.1.2015.

42.4 Vlera totale e shitjes ishte likuiduar totalisht nga blerësi me këste të ndryshme në ambientet e shoqërisë, në datat 28.12.2014 dhe 12.1.2015²⁵.

42.5 Referuar çmimeve të referencës së EKB-së²⁶ për periudhën në të cilën është nënshkruar kontrata e sipërmarrjes, për qytetin e Korçës, rezultoi se çmimi i blerjes së apartamentit prej 5.000.000 lekësh është më i lartë se referenca e tregut prej 3.637.800 lekësh. I pyetur nga Komisioni, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti sqaroi se nuk ka

²¹Shkresë nr. *** prot., datë 8.6.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 10.6.2022).

²²Me Dekretin nr. ***, datë 10.11.2011, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë është emëruar për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

²³Shkresë nr. *** prot., datë 30.12.2020, e ASHK/DV Korçë (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 5.1.2021).

²⁴Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 13.4.2018, noter B.Z, Korçë. Shitës shoqëria “K”, blerës TH dhe ZH.L. Kontratë e vënë në dispozicion nga ASHK Korçë me shkresën nr. *** prot., datë 30.12.2020 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 5.1.2021).

²⁵Neni 4 i kontratës së shitblerjes dhe shkresa nr. **** prot., datë 1.12.2022, e shoqërisë së ndërtimit “K”.

²⁶Udhëzim nr. 2, datë 6.8.2014.

shqyrtuar çështje, ku palë ndërgjyqëse të ketë qenë subjekti i ndërtimit “Konstruksion 93”, administratorët dhe/ose ortakët e shoqërisë.

42.6 Nga analiza financiare e kryer për prindërit e subjektit, rezultoi se ata kanë pasur mundësi të shlyejnë këstet e apartamentit me të ardhura të ligjshme.

Vlerësimi i Komisionit

42.7 Në analizë të provave të administruara, faktit që pagesa e apartamenteve është bërë në një kohë që subjekti nuk ishte më në përbërje familjare me prindërit, si dhe analizës financiare të kryer, trupi gjykues çmoi se nuk ka të dhëna që subjekti ka kontribuar në krijimin e kësaj pasurie.

42.8 Rezulton se në datën 26.9.2012, nëna e subjektit, shtetasja ZH.L, ka derdhur *cash* në llogari në “Raiffeisen Bank” vlerën 11.000 euro²⁷ dhe po në këtë datë ka hapur edhe një depozitë tjetër me vlerë 8.800 USD.

42.9 Nga hetimi i Komisionit rezultoi se vlera e këtyre depozitave është përdorur pjesërisht për pagesën e këstit të apartamentit të motrës së subjektit, shtetases E.L (blerë dhe regjistruar nga motra e subjektit, shtetasja E.L, për të cilin Komisioni hetoi dhe nuk u provua që subjekti të ketë kontribuar) dhe pjesërisht për krijimin e Fondit P**** në “Raiffeisen Bank” të nënës së subjektit, e cila më vonë është përdorur për blerjen e apartamentit të sipërpërmendur të prindërve.

42.10 Në analizë të provave të administruara, trupi gjykues çmoi se nuk ka të dhëna që subjekti ka kontribuar në krijimin e kësaj pasurie.

Analiza financiare për periudhën nëntor 2011 – 2016

43. Metodologjia e kryerjes së analizës financiare:

43.1 Për efekt të pasqyrit të metodologjisë së ndjekur, Komisioni në këtë analizë financiare është bazuar në: dokumentacionin e administruar dhe të vënë në dispozicion nga ILDKPKI-ja; deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë; deklaratën *Vetting*; pyetësorët me përgjigjet e subjektit; si dhe në korrespondencën e Komisionit me institucionet publike dhe jopublike.

Lidhur me pasuritë e krijuara, shpenzimet dhe kursimet e deklaruara u verifikuan dhe u krahasuan përputhshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë, deklaratën *Vetting*, si dhe aktet e tjera në dosjen e Komisionit.

43.2 Metodologjia e kryerjes së analizës financiare – për efekt të pasqyrit të metodologjisë së ndjekur, Komisioni në këtë analizë financiare është bazuar në: deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë; deklaratën *Vetting*; pyetësorët me përgjigjet e subjektit; si dhe në korrespondencën e Komisionit me institucionet publike dhe jopublike. Kjo metodologji shërben për të vlerësuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit

²⁷Shkresë nr. *** prot., datë 15.12.2020, nga “Raiffeisen Bank”.

dhe personit të lidhur për të realizuar kursimet, pasuritë e deklaruara dhe për të paguar shpenzimet, si dhe evidentimin e rasteve kur subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme pasuritë e krijuara (pasuri të luajtshme, të paluajtshme dhe likuiditete) dhe shpenzimet e kryera.

43.3 Analiza financiare e subjektit për periudhën e hetuar bazohet në të ardhurat e ligjshme sipas vërtetimeve për të ardhurat nga pagat në vlerë *neto*, lëshuar nga institucionet publike për subjektin e rivlerësimit²⁸, të cilat janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore në zbatim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

43.4 Shpenzimet e jetesës u bazuan në shpenzimet e përcaktuara në shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2019, të ILDKPKI-së, drejtuar Komisionit. Në llogaritjen e shpenzimeve jetike në analizën financiare është përfshirë numri i anëtarëve të familjes, për të cilët është bërë trajtimi i shpenzimeve jetike në bazë të deklaramit të subjektit në pyetësorin standard, por duke u mbështetur edhe në gjendjen familjare sipas certifikatave të gjendjes civile. Për vitin 2011 - 2012 është trajtuar familje me 2 anëtarë, pasi subjekti deklaroi në deklaratën para fillimit të detyrës si adresë banimi të saj atë të personit të lidhur dhe prej vitit 2012 deri në datën e lindjes së djalit është trajtuar familje me 2 anëtarë.

43.5 Shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit u analizuan bazuar në të dhënat e sistemit *TIMS*, si dhe në deklaramit e subjektit²⁹. Për përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit janë marrë si referencë vendimi nr. ***, datë 22.5.2019, i Kolegjit, si dhe deklaramit e subjektit. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit, kur subjekti ka deklaruar udhëtime për qëllime pune, të cilat janë provuar me dokumentacion. Gjithashtu, nuk janë konsideruar shpenzimet e akomodimit për rastet kur subjekti ka deklaruar se është akomoduar tek të afërmit dhe e ka provuar me dokumentacion deklaramin e tij. Në rastet e tjera, kur deklaramit e subjektit kanë qenë të pambështetura në dokumentacion provues, shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit janë konsideruar mbi bazën e vendimit nr. ***, datë 22.5.2019, të Kolegjit.

43.6 Shpenzimet për blerje automjesh³⁰ u bazuan në deklaramit vjetore të subjektit, pyetësorët, si dhe në dokumentacionin përkatës.

43.7 Për analizimin e kursimeve *cash* u morën në konsideratë deklaramit e kryera nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë.

43.8 Gjendja e likuiditeteve³¹ në bankë, në fillim dhe në fund të vitit të analizuar, bazuar në të dhënat e pasqyrave të lëvizjeve bankare.

²⁸Vërtetim nr. *** prot., datë 18.12.2020, nr. *** prot., datë 11.12.2020, nga DPT-ja; dhe leje lindje sipas vërtetimit datë 9.1.2017, aneks ***, nga ISSH-ja.

²⁹Përgjigjet e pyetësorit standard.

³⁰Shkresë nr. *** prot., datë 15.12.2020.

³¹Shkresat: nr. *** prot., datë 15.12.2020, nga BKT-ja; nr. *** prot., datë 15.12.2020, nga "Raiffeisen Bank"; nr. *** prot., datë 9.12.2020, nga "Alpha Bank"; nr. *** prot., datë 22.12.2020, "ABI Bank"; nr. *** prot., datë 16.12.2020, nga "Union Bank"; nr. *** prot., datë 15.12.2020, nga "Tirana Bank"; nr. *** prot., datë 17.12.2020, nga "Credins Bank"; nr. *** prot., datë 15.12.2020, nga BKT-ja.

43.9 Lidhur me pasuritë e krijuara, shpenzimet dhe kursimet e deklaruara u verifikuan dhe u krahasuan përputhshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë, deklaratën *Vetting*, si dhe aktet e tjera në dosjen e Komisionit.

43.10 Në konkludim të sa më sipër, analiza financiare për periudhën nëntor 2011 – 2016 rezultoi me vlerë negative prej 357.130 lekësh.

43.11 Me dërgimin e rezultateve të hetimit sipas pikës 2 të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e hetimit në lidhje me pamundësinë financiare për krijimin e depozitës me të ardhura të ligjshme, si dhe lidhur me pasaktësinë në deklaram, sa i përket mënyrës së shpenzimit të diferencës së depozitës me vlerën e kursimeve *cash* me burim këtë depozitë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

43.12 Pas dërgimit të rezultateve të hetimit me të cilat iu kalua barra e provës, subjekti depozitoi në Komision prapësime, duke shpjeguar se balanca negative e analizës financiare rezultonte vetëm në vitin 2016, e cila vinte nga mospërfshirja e kursimeve *cash* të ish-bashkëshortit në shumën 410.000 lekë, me burim bastet sportive të deklaruara në DIPP/2015. Ajo sqaroi se përgjegjësia për deklarimin e tyre dhe provueshmërinë për burimin e ligjshëm të këtyre të ardhurave ka qenë personale e personit të lidhur.

Subjekti kërkoi nga Komisioni rihartimin e analizës financiare për vitin 2016, pa përfshirë personin e lidhur, duke marrë në konsideratë marrëdhënien konfliktuale midis tyre dhe mungesën e komunikimit edhe për shpenzimet apo stilin e jetesës, shpenzimet e udhëtimeve të kryera nga ish-bashkëshorti, mungesën e shpenzimeve të qirasë gjatë qëndrimit të subjektit të rivlerësimit pranë prindërve të saj për periudhën prill - nëntor 2016 (periudhë gjatë së cilës ka qenë me leje lindjeje dhe në pyetësorin standard ka deklaruar se ka jetuar tek prindërit).

Bashkëlidhur parashtrimeve të saj, subjekti depozitoi në Komision analizën financiare të rihartuar prej saj për vitin 2016, e cila rezulton me vlerë pozitive prej 109.019 lekësh.

Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 16.12.2022, subjekti mbajti të njëjtin qëndrim dhe parashtrori të njëjtat shpjegime me ato të parashtruara me prapësimet e paraqitura me shkrim.

Vlerësimi i Komisionit

43.13 Në analizë të provave të administruara dhe shpjegimeve, trupi gjykues vlerësoi se, sikurse u arsyetua dhe më lart, pavarësisht nga marrëdhënia konfliktuale me bashkëshortin me të cilin ka zgjidhur martesën në qershor të vitit 2017 (vendim i cili ka marrë formë të prerë në qershor të vitit 2018), gjatë periudhës së rivlerësimit ish-bashkëshorti ka qenë

person i lidhur me subjektin dhe bazuar në pikën 13 të nenit 3³² dhe në nenin 30³³ të ligjit nr. 84/2016 analiza financiare duhet të përfshijë edhe personin e lidhur, sipas përcaktimeve ligjore.

43.14 Në lidhje me të ardhurat e personit të lidhur të subjektit nga bastet sportive, Komisioni, duke u nisur edhe nga praktika e tij dhe e Kolegjit³⁴, vërejtë se subjekti nuk përcolli dokumentacion, që provon marrjen e vlerës së deklaruar nga z. G.M, por edhe shlyerjen e detyrimeve tatimore mbi këto vlera. Gjithashtu, trupi gjykues mbajti në vëmendje faktin që, pavarësisht se personi i lidhur i subjektit ka deklaruar të ardhura nga lojërat e fatit, ai nuk ka deklaruar shpenzimet e kryera prej tij për të përfituar këto të ardhura dhe shpenzimet e tjera për efekt të kësaj veprimtarie dhe nga ana e Komisionit nuk u arrit të provoheshin këto shpenzime.

43.15 Pas vlerësimit dhe konsideratave të mësipërme nga Komisioni, rezultati i analizës financiare të subjektit të rivlerësimit për periudhën nëntor 2011 – 2016 rezulton të jetë me vlerë negative prej 269.875 lekësh.

43.16 Në lidhje me problematikat e analizës financiare, trupi gjykues çmon se këto mangësi të burimeve financiare nuk janë të mjaftueshme që të sjellin aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësimi sigurisht që duhet të kryhet nëpërmjet një analize kritike, por ai duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

Konkluzion përfundimtar për kriterin e pasurisë

44. Komisioni, në përfundim të këtij hetimi administrativ, pasi shqyrtoi të gjithë dokumentacionin e administruar, përgjigjet dhe provat e paraqitura nga subjekti në pyetësorët e dërguar, si dhe provat dhe parashtrimet në përgjigje të barrës së provës, çmon se në vendimarrjen e tij përfundimtare, siç konstatohet edhe më lart, duhet të marrë në konsideratë, si vijon:

- i. Subjekti ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë, ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij dhe nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, në zotërim ose në përdorim të tij.
- iii. Ekzistenca e një balance të vogël në analizën financiare nuk është në atë shkallë sa të përbëjë shkak për shkarkim, sipas pikës 3 të nenit 61 dhe nuk ndikon në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit, duke cënuar besimin e publikut te

³²“Person i lidhur” është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, ..., i përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerësimit, ... për periudhën e rivlerësimit”.

³³“Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij”.

³⁴Vendimi nr. ***, datë 14.10.2019, i Kolegjit për subjektin e rivlerësimit A.S; vendimi nr. ***, datë 10.9.2020, i Komisionit, për subjektin e rivlerësimit A.G.

drejtësia.

- iv. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Olkeda Lice ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

45. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

45.1 Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Olkeda TH Manellari, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 5.2.2021, të KDZH-së, nga ku rezulton se:

- formulari i deklaramentit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016;
- subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej saj në deklaratën për kontrollin e figurës;
- për të nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar³⁵.

45.2 Në konkluzion të këtij raporti, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Olkeda TH Manellari.

46. Komisioni i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme³⁶ me kërkesën për informacion në lidhje me *indicie* të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve për përfshirjen e subjektit drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta, që cenojnë figurën e tij.

46.1 Prokuroria e Përgjithshme ka përcjellë³⁷ informacionin e ardhur nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, nga të cilat rezulton se për subjektin e rivlerësimit është

³⁵DSIK-ja ka sqaruar se nga autoritetet verifikuese janë vënë në dijeni se: “Shtetasi G.L.M (bashkëshorti i subjektit) në datën 24.9.2002 është marrë në evidencë si person me precedent kriminal, për arsye se ndaj tij ka të dhëna se merret me trafik mjetesesh motorike nga Bullgaria në Shqipëri”. Në vijim, DSIK-ja ka shprehur mendimin se nisur nga fryma dhe qëllimi i ligjit, i cili është përcaktimi i rregullave të posaçme për rivlerësimin kalimtar të të gjithë subjekteve të rivlerësimit, gjithashtu dhe kontakteve të papërshtatshme që mund të ketë subjekti i rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar, mendoj se nuk ndodhemi para rastit të papërshtatshmërisë së subjektit znj. Olkeda Lice Manellari, pasi veprimet e kundërligjshme të bashkëshortit të saj nuk janë objekt i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti nuk ka qenë i martuar me z. G.M në vitin 2002. Martesën e ka lidhur në vitin 2012.

³⁶Shkresë nr. *** prot., datë 27.11.2020.

³⁷Me shkresën nr. *** extra prot., datë 4.3.2021 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 5.3.2021).

regjistruar një kallëzim penal³⁸, për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Konkretisht:

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, më 29.7.2019, ka regjistruar kallëzimin penal³⁹ nr. *** ndaj gjyqtarës Olkeda Lice, për kryerjen e veprës penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Për këtë kallëzim penal, më 2.9.2020, është marrë vendimi “Për mosfillimin e procedimit penal”, i cili nuk është ankimuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë⁴⁰.

Vlerësimi i Komisionit

47. Në lidhje me informacionin e përcjellë nga DSIK-ja, se kjo e fundit nga autoritetet ligjzbatuese është vënë në dijeni se shtetasi G.L.M (ish-bashkëshorti i subjektit, me të cilin ka qenë e martuar gjatë periudhës së rivlerësimit) në datën 24.9.2002, është marrë në evidencë si person me precedent kriminal për arsye se ndaj tij ka të dhëna se merret me trafik mjetesh motorike nga Bullgaria në Shqipëri, përtej arsytimit dhe konkluzionit të DSIK-së, se subjekti është i përshtatshëm për vijimin e detyrës, Komisioni analizoi se:

47.1 Në pikat 3 dhe 4 të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, përcaktohet se: “3. Nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën. 4. [...] Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të bëjë deklaratime të pasakta ose të fshehtë kontaktet me persona të përfshirë në krimin e

³⁸Shkresë nr. *** prot., datë 11.12.2020, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, përcjellë në Komision nga Prokuroria e Përgjithshme.

³⁹Ky kallëzim është dërguar për kompetencë pranë kësaj prokurorie, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

⁴⁰Konkretisht, kallëzuesi L.B në kallëzimin penal ka parashtruar se gjyqtarja Olkeda Lice, me paramendim dhe në kundërshtim me rregullat elementare të zhvillimit të një seance gjyqësore, ka zhvilluar një seancë gjyqësore. Një polic i ka thënë kallëzuesit të shkonte në sallë, pasi më parë ishte kontrolluar nga detektori. Pasi ka pritur në korridor për 15 minuta, një person civil i ka bërë një tjetër kontroll në tërë trupin. Ai ka marrë pjesë në një seancë gjyqësore, në prani të forcave policore të policisë së burgut dhe në prani të dhjetëra personave në pranga. Pretendon gjithashtu që gjykata ka shkelur në mënyrë flagrante të drejtat e njeriut në gjykimin dhe zhvillimin e një seance gjyqësore dhe kërkon, ndër të tjera, të anulohet kjo seancë gjyqësore dhe tjetra e planifikuar pas saj.

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka arsyetuar se nga analiza tërësore e rethanave të faktit dhe provave të administruara vlerëson se fakti i kallëzuar duhet të mos fillohet, pasi nuk ndodhemi përpara elementeve të veprës penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe as të ndonjë vepre tjetër penale. Ajo arsyeton se pavarësisht se kallëzuesi e quan antiligjor kontrollin që i është bërë para hyrjes në gjykatë, kjo është një procedurë standarde, së cilës i nënshtrohen të gjithë personat që hyjnë në ambientet e gjykatës dhe në përputhje me ligjin, pasi qëllimi i saj është të garantojë rendin dhe sigurinë publike, jetën dhe shëndetin e të pranishmëve në ambientet e gjykatës.
2. Po kështu, vijon arsyetimi, edhe zhvillimi i seancës gjyqësore në të njëjtin ambient (sallë gjyqësore) ku janë të pranishëm edhe palë të tjera, përfshirë këtu dhe persona të arrestuar, nuk përmban elemente të ndonjë vepre penale, por vjen si rezultat i numrit të madh të seancave gjyqësore të planifikuara në raport me sallat gjyqësore në dispozicion të gjyqtarëve.
3. Në lidhje me pretendimin e kallëzuesit për anulimin e seancave gjyqësore si më lart, prokuroria ka arsyetuar se ky nuk është një pretendim i karakterit penal dhe, si i tillë, nuk përbën objekt të veprimtarisë hetimore të prokurorit.
4. Gjithashtu, ka arsyetuar se të gjitha pretendimet që kallëzuesi ka në lidhje me mënyrën e zhvillimit të gjykimit apo me vendimet e ndërmjetme të gjyqtarës, ka të drejtë t’i kundërshtojë së bashku me vendimin përfundimtar në Gjykatën e Apelit Vlorë, si e vetmja gjykatë, e cila mund të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”.

47.2 Për të vlerësuar nëse z. G.M konsiderohet person i përfshirë në krimin e organizuar, Komisioni i referohet përkufizimit të ligjit nr. 84/2016, ku në pikën 15 të nenit 3 parashikohet se: *“Person i përfshirë në krimin e organizuar është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, ‘Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë’, të ndryshuar, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë [...]”.*

Duke pasur parasysh sa më lart, Komisioni analizoi:

Së pari, në analizë të kësaj dispozite konstatohet se vepra penale, për të cilën personi i lidhur i subjektit është marrë në evidencë si person me precedent kriminal, nuk bën pjesë në veprat e përcaktuara në ligjin nr. 84/2016. Konkretisht, z. G.M është marrë në evidencë si person i përfshirë në veprimtarinë në fjalë në vitin 2002, ndërsa dispozita e sipërcituar e ligjit nr. 84/2016 referon në veprat e parashikuara në ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009, pra referon në një ligj që ka hyrë në fuqi 7 vjet më pas. Edhe nëse Komisioni do t’i referohej dispozitave, në të cilat referon pika 15 e nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, vepra për të cilën ai është marrë në evidencë nuk bën pjesë në veprat e parashikuara nga kjo dispozitë⁴¹.

Së dyti, informacioni të cilit i referohet DSIK-ja i përket vitit 2002, ndërsa subjekti i rivlerësimit ka lidhur martesë me z. G.M në vitin 2012, pra 10 vjet më pas.

Konkluzion përfundimtar për vlerësimin e kontrollit të figurës

Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës, si dhe nuk rezultuan të dhëna të tjera që subjekti të ketë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në pikën 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016.

Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Olkeda Lice ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

⁴¹Pika 1 e nenit 3 të ligjit nr. 10192/3.12.2009 parashikon: *“Dispozitat e këtij ligji zbatohen për pasuritë e personave, që zotërohen plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, siç përcaktohet në pikën 2 të këtij neni, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në indicie, për: a) pjesëmarrje dhe kryerje të krimeve nga banda e armatosur, organizata kriminale dhe grup i strukturuar kriminal, të parashikuara nga kreu XI i Kodit Penal; b) pjesëmarrje dhe kryerje e krimeve nga organizata terroriste dhe krimeve për qëllime terroriste, parashikuar nga kreu VII i Kodit Penal; c) kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet 109, 109/b, 110/a, 128/b, 278/a, 282/a, 283, 283/a dhe 284/a të Kodit Penal; ç) pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal; d) kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet 164/a, 164/b, 183, 244, 244/a, 245, 245/1, 256, 257, 257/a, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e të Kodit Penal, në rastet kur ekzistojnë indicie për përfitim pasuror të paligjshëm”.*

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

48. Në zbatim të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016 është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit Olkeda Lice (Manellari), bazuar në raportin për analizimin e aftësive profesionale, dorëzuar në Komision nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me shkresën nr. *** prot., datë 29.6.2021, si dhe në gjetjet e Komisionit gjatë hetimit administrativ. Raporti i përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale;
- ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

48.1 Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëvlerësimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (ii) pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

GJETJET NGA FORMULARI I VETËVLERËSIMIT DHE DOKUMENTET E PARAQITURA NGA SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT

Formulari paraqitet i nënshkruar dhe i plotësuar sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Duke iu referuar të dhënave të deklaruara në formularin e vetëvlerësimit, subjekti i rivlerësimit Olkeda Lice (Manellari), në periudhën 1.2012 – 1.2014, ka kryer stazhin profesional si kandidate për magjistrate në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në periudhën 23.1.2014 e në vazhdim, pra edhe aktualisht, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

1. Në lidhje me tri dokumentet e llojit “vendim gjyqësor”, të përzgjedhura nga subjekti

Subjekti i rivlerësimit ka përzgjedhur dhe ka paraqitur tri dokumente të llojit “vendim gjyqësor”, të cilat i përkasin vitit 2016 dhe janë një vendim penal dhe dy vendime civile:

- vendimi gjyqësor civil nr.***, datë 6.11.2014;
- vendimi gjyqësor civil nr.***, datë 6.11.2014;
- vendimi gjyqësor penal nr.***, datë 16.2.2016.

1.1 Të tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti paraqiten të standardizuar në drejtim të organizimit formal dhe të strukturës, janë të qartë dhe plotësojnë standardet e një vendimi të arsyetuar.

1.2 Në dy prej vendimeve nuk u konstatuan veprime apo mosveprime individuale të subjektit të rivlerësimit që cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor, ndërsa në

njërin prej tyre (dokumenti nr. 2 – vendimi nr. ***, datë 6.11.2014) u konstatua se gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur 8 muaj e 24 ditë, në intervalin kohor 13.2.2014 – 6.11.2014. Pra, rezultoi se gjykimi është realizuar në shkelje të afatit standard 6-mujor, të përcaktuar nga pika 5, germa “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

1.3 Kjo çështje me datë regjistrimi 13.2.2014 iu përket palëve: paditës – I.P, M.P, E.P; i paditur – Drejtoria e Policisë e Qarkut Fier; persona të tretë – Zyra e Gjendjes Civile Lushnjë dhe Ministria e Punëve të Brendshme dhe ka si objekt “Njohje e pavërtetësisë së dokumentit, pasaporta me nr. ***, e lëshuar në datën 23.7.2004 nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Fier, në emër të shtetases I.P, për shkak se përbërësit e gjendjes civile: emri – I dhe vendlindja Gjirokastër janë të gabuara. Njohjen si të vërtetë të dokumentit pasaporta biometrike me nr. ***, të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme në datën 3.12.2013, në emër të shtetases I.P [...].

1.4 E parë në këndvështrim të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni konstatoi se nga ana e subjektit ka pasur një organizim të dobët të punës në shqyrtimin e kësaj çështjeje.

1.5 Me dërgimin e rezultateve të hetimit sipas pikës 2 të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e hetimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

1.6 Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, me të cilat iu kalua barra e provës, subjekti depozitoi në Komision shpjegime të shoqëruara me dokumentacion. Ajo shpjegoi se llogaritja e afatit standard të gjykimit fillon që nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim dhe se që nga kjo datë deri në përfundimin e çështjes kanë kaluar afërsisht 7 muaj (pa llogaritur muajin gusht që është pushim i detyrueshëm për gjyqtarët), duke u tejkualuar kështu me 1 muaj afati standard (pa llogaritur këtu shkaqet e tjera objektive).

Gjithashtu, shpjegoi se ka pasur shtyrje seancash, por gjithmonë për arsye procedurale dhe se në tejkalimin e afatit të gjykimit në këtë rast kanë ndikuar faktorë objektivë si: kompleksiteti i çështjes, sjellja e palëve dhe ngarkesa e saj me procese të tjera gjyqësore. Gjithashtu, ka theksuar se *efektshmëria në punë dhe rendimenti i gjyqtarit nuk mund të matet as me një dhe as me tre çështje gjyqësore, por duhet parë dhe vlerësuar në tërësi dhe se nga të dhënat statistikore që gjykata i ka vënë në dispozicion KLGJ-së rezulton se për periudhën që referohet KLGJ-ja në raport, subjekti ka tejkualuar standardin sasior në fuqi me 104 çështje themeli ose me rreth 75%, pasi një gjyqtar i dhomës civile të seksionit të përgjithshëm duhet të gjykojë jo më pak se 120 çështje në vit që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtare, ndërkohë që ajo ka përfunduar së gjykuari 244 çështje të tilla.*

Vijon shpjegimin se pavarësisht se çështja është gjykuar në vitin 2014, nëse do t'i referohemi nenit 399/2, paragrafi 3 i Kodit të Procedurës Civile të ndryshuar, të gjitha shkaqet e përmendura më sipër nuk duhet të llogariten në tejkalimin e afatit të arsyeshëm.

Me pretendimin se sot ligjvënësi ka vendosur parametra matës realë për kohëzgjatjen e gjykimit, ka kërkuar nga Komisioni që ato të merren në konsideratë edhe në rastin konkret, për të provuar se tejkalimi i afatit të gjykimit nuk ka ardhur nga paaftësia e saj profesionale ose nga menaxhimi i dobët i procesit gjyqësor. Gjithashtu, ka shpjeguar se asnjë seancë gjyqësore nuk është shtyrë për shkak të sjelljes ose menaxhimit të dobët nga ana e saj si gjyqtare dhe se madje ajo nuk ka marrë asnjëherë kohë për vendimmarrje të ndërmjetme ose për shpalljen e vendimit përfundimtar.

Në përfundim, subjekti është shprehur: *“Më lejoni të sjell në vëmendje të trupit gjykues se asnjëherë nuk kam treguar paaftësi në mirëmenaxhimin e afateve ligjore ose orientuese, por duke i pasur si busull orientuese këto afate, jam përpjekur që procesi gjyqësor të zhvillohet duke respektuar të gjithë komponentët e një procesi të rregullt gjyqësor, duke mos i kthyer afatet në qëllim në vetvete, në dëm të parimeve të tjera të këtij procesi, i cili ka në fokus zgjidhjen e drejtë të çështjes”*.

1.7 Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 16.12.2022, subjekti mbajti të njëjtin qëndrim dhe parashtroi të njëjtat shpjegime me ato të parashtruara me prapësimet e paraqitura me shkrim.

Vlerësimi i Komisionit

Në analizë të provave të administruara dhe shpjegimeve, trupi gjykues vlerësoi se shpjegimet e dhëna nga subjekti janë bindëse dhe tejkalimi i afatit standard të gjykimit nuk ka ardhur për shkaqe subjektive.

2. Në lidhje me pesë dosjet e përzgjedhura me short

Në datën 4.12.2020, në ambientet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier u përzgjedhën me short pesë dosje. Konkretisht:

- dosja nr. 1, që i përket vendimit nr. ***, datë 27.7.2015;
- dosja nr. 2, që i përket vendimit nr. ***, datë 18.12.2015;
- dosja nr. 3, që i përket vendimit nr. ***, datë 15.5.2015;
- dosja nr.4, që i përket vendimit nr. ***, datë 22.10.2015;
- dosja nr.5, që i përket vendimit nr. *** akti, datë 25.8.2014.

Në të gjitha këto çështje subjekti i rivlerësimit ka gjykuar si gjyqtare e vetme.

Në dosjet nr. 1 dhe 2 nuk u konstatuan veprime apo mosveprime individuale të subjektit të rivlerësimit që cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

Dosja nr. 3 – çështja u depozitua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier në datën 20.3.2014 dhe me shortin elektronik të zhvilluar në të njëjtën datë iu caktua për gjykim gjyqtares Olkeda Manellari, e cila me vendimin e datës 21.3.2014 caktoi seancën përgatitore më 3.4.2014, ora 13:00.

U zhvilluan 7 seanca përgatitore dhe 11 seanca gjyqësore, pasi ka pasur shumë shtyrje të seancave⁴².

Në përfundim, me vendimin e sipërpërmendur subjekti i rivlerësimit ka vendosur: “Rrëzimin e padisë. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë, brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes së vendimit [...]”.

Ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim paditësi dhe Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur⁴³ lënien në fuqi të vendimit në fjalë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier në datën 28.5.2015, pas 13 ditësh nga shpallja, duke shkelur afatin 10-ditor të parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur 1 vit, 1 muaj dhe 25 ditë në intervalin kohor 20.3.2014 - 15.5.2015. Gjykimi i çështjes u realizua në shkelje, pasi nuk ka respektuar afatin standard 6-mujor, të përcaktuar nga pika 5, germa “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

Në lidhje me aspektin procedural të këtij procesi gjyqësor, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka konstatuar disa problematika, të cilat kanë të bëjnë me zvarritjen e gjykimit për shkak të sjelljes së palëve, por edhe prej organizimit të dobët të punës nga ana e gjyqtarës. Megjithëse janë ezauruar shtatë seanca përgatitore, subjekti nuk arriti të përgatiste siç duhet çështjen, duke shtyrë dy seanca gjyqësore për të paraqitur paditësi një kopje të provave për palën e paditur. Nga 18 seanca të planifikuara e të zhvilluara, vetëm dy seanca ishin produktive.

U konstatua se procesverbalet për kryerjen e veprimeve përgatitore dhe të seancave gjyqësore, përgjithësisht, përmbushin kriteret e nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile,

⁴²Seancat përgatitore: Seanca e parë përgatitore u shty duke i lënë detyrë paditësit të saktësojë objektin e padisë dhe të dorëzojë kopje të provave për palët dhe për gjykatën. Në seancën e dytë përgatitore gjyqtarja ka konstatuar se sërisht nuk është përcaktuar qartë vlera e padisë dhe për të plotësuar këtë të metë të padisë, vendosi shtyrjen e seancës përgatitore. Seanca e tretë përgatitore u shty me qëllim që paditësi të paguajë taksën sipas vlerës së padisë dhe të marrë avokat në gjykim, sipas deklaramit të tij. Në seancën e katërt përgatitore nuk janë paraqitur tre nga personat e tretë, të cilët ndodheshin jashtë shtetit. Gjykata ka pranuar kërkesën e paditësit për të zhvilluar gjykimin në mungesë të tyre. Më pas, pala e paditur ka kërkuar të përsëritet njoftimi për personat e tretë, të cilët nuk kanë marrë njoftim dhe gjyqtarja ka vendosur të shtyjë seancën përgatitore, duke urdhëruar sekretarinë të përsërisë njoftimet. Seanca e pestë përgatitore u shty për të përsëritur njoftimin për personat e tretë, të cilët ndodhen jashtë shtetit. Seanca e gjashtë përgatitore u shty duke i lënë detyrë paditësit që të përcaktojë adresat e personave të tretë që ndodhen jashtë shtetit, në të kundërt do të procedohet me kthimin e akteve. Në seancën e shtatë përgatitore, gjykata vendosi ta konsiderojë të përfunduar seancën përgatitore dhe kaloi çështjen në gjykim në seancë gjyqësore.

Seancat gjyqësore: Seanca e parë gjyqësore (datë 10.9.2014) u shty për të përsëritur njoftimin për dy nga personat e tretë. Seanca e dytë gjyqësore u shty për të përsëritur njoftimin për dy nga personat e tretë dhe për përfaqësuesin e të paditurit, të cilët nuk kanë marrë dijeni rregullisht. Seanca e tretë gjyqësore u shty “për t’i dhënë mundësi palës paditëse të ndërtojë mbrojtjen e vet, duke kërkuar marrjen e provave shkresore dhe provave të kërkuara nga ligji, si dhe për të sjellë prova që gjykata ia la detyrë”. Në seancën e katërt gjyqësore (datë 11.11.2014) gjykata i la detyrë paditësit të sjellë një kopje të provave të depozituara në gjykatë për të paditurin, por nuk del e qartë nëse është fjala për provat, të cilat i ishin lënë detyrë që në seancën e parë përgatitore apo është fjala për prova të reja të depozituara gjatë kësaj seance. Seancat e tjera janë zhvilluar dhe janë shtyrë për përsëritje të fletëthirrjeve, për t’i dhënë kohë të paditurit për të përgatitur përgjigjet për pyetjet e paditësit.

⁴³Vendimi nr. ***, datë 11.5.2017.

por janë të panënshkruar nga gjyqtarja, janë nënshkruar vetëm nga sekretarja. Nga dokumentacioni në dosjen e vëzhguar nuk u konstatuan të meta⁴⁴. Aktet e prodhuara nga gjykata u konstatuan të rregullta nga ana formale, dosja është e inventarizuar rregullisht dhe renditja e akteve nuk vështirëson përdorimin e saj. Procesverbalet tregojnë se komunikimi i subjektit të rivlerësimit, për sa i përket kërkesave paraprake, leximit të të drejtave dhe detyrave dhe dhënies së fjalës palëve sipas radhës, ka qenë i qartë. Gjuha e përdorur është normale, komunikimi është në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë. Nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elemente që lidhen me paanësinë e gjyqtarit. Nuk pati kërkesë për përjashtimin e gjyqtarës nga gjykimi i çështjes nga asnjëra palë.

Vendimi paraqitet me strukturë të qëndrueshme, është i qartë dhe janë respektuar rregullat e drejtshkrimit. Ai përmban elementet e nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile, është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

E parë në këndvështrim të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni konstatoi se nga ana e subjektit ka pasur një organizim të dobët të punës në shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Me dërgimin e rezultateve të hetimit sipas pikës 2 të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e hetimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit me të cilat iu kalua barra e provës, subjekti depozitoi në Komision shpjegime të shoqëruara me dokumentacion, të cilat janë parashtruar në mënyrë të përmbledhur së bashku me shpjegimet e depozituara për dosjen nr. 4 (që do të trajtohet më poshtë), për shkak të natyrës së njëjtë të problematikave të konstatuara në këto dy dosje.

Dosja nr. 4 – çështja u depozitua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier në datën 31.7.2014 dhe me shortin elektronik të zhvilluar në të njëjtën datë iu caktua për gjykim gjyqtarës Olkeda Manellari, e cila me vendimin e datës 5.9.2014 caktoi seancën përgatitore më 29.9.2014, ora 10:30.

U zhvilluan 7 seanca përgatitore⁴⁵ dhe 11 seanca gjyqësore. Në përfundim, me vendimin e sipërpërmendur subjekti i rivlerësimit vendosi: *“Pranimin e padisë. Detyrimin e të paditurave të njohin paditësit TH.Z e A.Z, bashkëpronarë në apartamentin e banimit ... ”*.

⁴⁴Në dosje janë përfshirë rregullisht kërkesëpapia, fleta e shortit, vendimi për caktimin e seancës së pajtimit, aktet e njoftimit për palët, procesverbalet e seancave gjyqësore, provat shkresore, vendimi gjyqësor përfundimtar, etj.

⁴⁵Seancat përgatitore u shtynë për plotësim të të metave të padisë për të siguruar njoftimin e rregullt të palëve dhe për shkak të mungesës në një seancë të përfaqësueses së paditësit.

Ndaj vendimit të mësipërm është ushtruar ankimi dhe Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 31.5.2017, vendosi: *“Ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 22.10.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në këtë mënyrë: Rrëzimin e padisë”*.

Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier në datën 2.11.2015, pas 11 ditësh nga shpallja, duke shkelur me 1 ditë afatin 10-ditor të parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur 1 vit, 2 muaj e 22 ditë në intervalin kohor 31.7.2014 - 22.10.2015. Gjykimi i çështjes u realizua në shkelje, pasi nuk ka respektuar afatin standard 6-mujor, të përcaktuar nga pika 5, germa “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

KLJG-ja ka konstatuar se gjykimi u zvarrit për shkak të palëve ndërgjyqëse, por edhe prej një organizimi jo të mirë të punës nga ana e gjyqtarës Manellari. Konstatohet se seancat e para dështuan për shkak të pamundësisë për të siguruar njoftimin e rregullt të palëve të paditura, ku në dy raste u vendos edhe njoftimi me shpallje. Gjyqtarja ndërhyri edhe në zyrën përkatëse të gjendjes civile për të marrë adresat e të paditurve. Problemi që lidhet me mangësi të gjyqtarës fillon me ezaurimin e seancës përgatitore dhe kalimin e çështjes për gjykim. Para se çështja të kalojë për gjykim në seancë gjyqësore, gjyqtari duhet të sigurohet se e ka përgatitur si duhet çështjen, se ka siguruar të gjitha provat e nevojshme që do të shqyrtohen në seancë gjyqësore me qëllim evitimin e shtyrjes pa fund të seancave gjyqësore për të marrë prova. Rezultoi se veprimet përgatitore përfunduan në seancën e tetë, por disa seanca rresht (4 seanca) u shtynë për të marrë apo për të sjellë prova të dyja palët ndërgjyqëse. Kjo tregon se çështja nuk u përgatit si duhet.

Gjithashtu, në zvarritjen e gjykimit ka ndikuar në disa seanca edhe planifikimi i gjatë i tyre mbi një muaj nga njëra-tjetra, ku afati i planifikimit të tyre është mbi një muaj dhe nuk jepet një shpjegim në procesverbal për këtë afat planifikimi lidhur me ngarkesën në punë të gjyqtarës në atë periudhë.

Ka pasur mungesa të përfaqësueses së paditësve me pretendimin se ndodhet në gjykata të tjera, të cilat janë vlerësuar si të justifikuar nga gjyqtarja.

U konstatua se procesverbalet për kryerjen e veprimeve përgatitore dhe të seancave gjyqësore, përgjithësisht, përmbushin kriteret e nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile dhe janë të nënshkruar rregullisht. Nga dokumentacioni në dosjen e vëzhguar nuk u konstatuan të meta⁴⁶. Aktet e prodhuara nga gjykata u konstatuan të rregullta nga ana formale, dosja është e inventarizuar rregullisht dhe renditja e akteve nuk vështirëson përdorimin e saj. Procesverbalet tregojnë se komunikimi i subjektit të rivlerësimit, për sa i përket kërkesave paraprake, leximit të të drejtave dhe detyrave dhe dhënies së fjalës palëve sipas radhës ka qenë i qartë. Gjuha e përdorur është normale, komunikimi në

⁴⁶Në dosje janë përfshirë rregullisht kërkesëpapia, fleta e shortit, vendimi për caktimin e seancës së pajtimit, aktet e njoftimit për palët, procesverbalet e seancave gjyqësore, provat shkresore, vendimi gjyqësor përfundimtar, etj.

përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë. Nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elemente që lidhen me paanësinë e gjyqtarit. Nuk pati kërkesë për përjashtimin e gjyqtarëve nga gjykimi i çështjes nga asnjëra palë dhe është për t'u theksuar që seancat gjyqësore janë regjistruar në audio, në funksion të transparencës dhe solemnitetit të gjykimit.

Vendimi paraqitet me strukturë të qëndrueshme, është i qartë dhe janë respektuar rregullat e drejtshkrimit. Ai përmban elementet e nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile, është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

E parë në këndvështrim të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni konstatoi se nga ana e subjektit ka pasur një organizim të dobët të punës në shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Me dërgimin e rezultateve të hetimit sipas pikës 2 të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e hetimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit me të cilat iu kalua barra e provës, subjekti depozitoi në Komision shpjegime të shoqëruara me dokumentacion, të cilat janë parashtruar më poshtë në mënyrë të përmbledhur, së bashku me shpjegimet e depozituara për dosjen nr. 3 (trajtuar më lart), për shkak të natyrës së njëjtë të problematikave të konstatuara në këto dy dosje.

Në parashtrimet e tij drejtuar Komisionit, subjekti shpjegoi, fillimisht, në mënyrë të përgjithshme se afatet standarde të caktuara me vendim të KLD-së janë afate orientuese për punën e gjyqtarit dhe jo penalizuese, pasi nuk parashikohen si afate taksative në ligjin e kohës dhe se: *“Me ndryshimet e Kodit të Procedurës Civile janë parashikuar tashmë afatet e arsyeshme për gjykimin e çështjeve dhe nëse do t'i referohemi ndryshimeve, afati i parashikuar nuk është tejkaluar nga ana ime për asnjë nga rastet e konstatuara”*. Në vijim, subjekti kërkon të mbahet parasysh nga Komisioni vendimi nr. 5, datë 12.12.2013, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku kjo e fundit ka disponuar se: *“... pavarësisht afateve të parashikuara në ligjet tona procedurale, qofshin ato civile dhe penale, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë dhe janë të ndërgjegjshme se jo gjithmonë këto afate mund të zbatohen me rigorozitet nga ana e gjyqtarëve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre dhe jo gjithmonë mosrespektimi i tyre është shkak ligjor për marrjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve nga ana e KLD-së. Pamundësia për të respektuar maksimalisht këto dispozita mund të justifikohet nga ekzistenca e shkaqeve objektive, të cilat nuk varen nga gjyqtarët dhe që mund t'i pengojnë në respektimin rigoroz të këtyre normave, siç mund të jenë ngarkesa e madhe në punë, kompleksiteti i çështjeve në ngarkim; sjellja e palëve gjatë procesit; pamundësia objektive e gjykatave për zhvillimin*

e procesit gjyqësor, shkaqe të justifikuara shëndetësore apo familjare, të cilat mund të kenë ndikim direkt tek gjyqtari dhe nuk e lejojnë atë të ushtrrojë detyrën e tij, etj.”.

Për dosjet konkrete për të cilat iu kalua barra e provës, shpjegoi se:

a) Në lidhje me dorëzimin me vonesë në sekretari të vendimit të arsyetuar, në njërin rast kjo ka ardhur për shkak të ngarkesës së madhe të saj në punë dhe mungesës së stafit mbështetës, si dhe impenjimit të sekretares gjyqësore me punë administrative, ndërsa në lidhje me rastin tjetër ka shpjeguar se vendimi është dorëzuar në afat në sekretari, pasi dita e fundit e dorëzimit të vendimit në sekretari binte ditë e diel dhe bazuar në nenin 143/3 të Kodit të Procedurës Civile, dita e fundit e dorëzimit ishte dita pasardhëse që është pikërisht dita kur është dorëzuar vendimi.

b) Në lidhje me tejkalimin e afatit standard 6-mujor të gjykimit, subjekti ka sqaruar se në njërin prej rasteve kjo ka ardhur për disa shkaqe si: fakti që në proces ka pasur 2 të paditur dhe 4 persona të tretë, të cilët në respektim të parimit të aksesit në gjykatë dhe kontradiktoritetit duhet të marrin dijeni rregullisht për procesin; fakti që paditësi ishte 82 vjeç, padinë e kishte hartuar vetë dhe mbrojtjen e ndërtoi vetë (pavarësisht se kishte avokat në disa seanca), me sa mund ta lejonte mosha dhe njohuritë mbi procedurën; fakti që sipas ligjit të kohës, palët mund të kërkonin prova të reja edhe në seancë gjyqësore, kështu që nuk mund t'i kërkonte paditësit që të përgatiste prova për palët që në seancë përgatitore, për më tepër në kushtet kur ajo nuk kishte dijeni për provat që ekzistonin. Ka vijuar shpjegimin se qëllimi i gjykatës është të krijojë akses në gjykatë edhe për shtresat vulnerabël dhe se ka vënë në fokus aksesin në gjykatë të një të moshuari, duke mos e parë çështjen si numër. Gjithashtu, ka shpjeguar se ka pasur zgjatje të procesit, për shkak të njoftimit të palës së paditur dhe personave të tretë, pasi natyra e mosmarrëveshjes kërkonte që të paditurit të merrnin dijeni rregullisht dhe jo formalisht me shpallje, ndërkohë që vetë paditësi këmbëngulte që personat ishin në Shqipëri dhe duhet të njoftoheshin personalisht që të jepnin versionin e tyre.

Gjithashtu, ka shpjeguar se kjo çështje është shqyrtuar edhe nga Gjykata e Apelit, e cila ka vlerësuar sjelljen dhe rolin e saj mirorganizues në këtë çështje.

Në lidhje me rastin tjetër ku është konstatuar se gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur 1 vit, 2 muaj e 22 ditë, në shkelje të afatit standard 6-mujor, subjekti ka sqaruar se çështja fillimisht i është caktuar një tjetër gjyqtareje dhe pas emërimit të saj në një gjykatë tjetër është marrë në dorëzim nga subjekti dhe afati i llogaritur nga marrja në dorëzim prej saj është 1 vit e 22 ditë. Në vijim, ka shpjeguar se zgjatja e procesit ka ardhur për shkak të ngarkesës së madhe në punë, pasqyruar edhe në raportin e KLGJ-së, e cila ka evidentuar se subjektit në vitin 2015 i janë caktuar në total 599 çështje, nga të cilat ka përfunduar 519. Gjithashtu, ka shpjeguar se ligji procedural i kohës lejonte të merrje prova të reja në seancë gjyqësore, shtyrjet e seancave kanë qenë për shkaqe të justifikuara, të pasqyruara në procesverbalet audio dhe asnjëherë për shkakun e saj, se ajo si gjyqtare ka luajtur rol aktiv në mbledhjen e provave në organet shtetërore dhe se ka respektuar si afatin

për caktimin e seancës së parë përgatitore, ashtu edhe afatin ligjor për diskutimin përfundimtar të palëve.

c) Në lidhje me mosnënshkrimin e procesverbaleve gjyqësore, subjekti ka shpjeguar se kërkesa ligjore e “detyrimit për nënshkrimin”, që mund të çojë në argumentin se procesverbalet janë të pavlefshme kur nuk janë nënshkruara nga personeli që i ka përpiluar ato, është e zbatueshme vetëm për procesverbalet e mbajtura me mjetin me shkrim, ndërsa për rastin kur procesverbali mbahet me mjetin e regjistrimit audio, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin unifikues nr.1/2015, kanë mbajtur qëndrimin se mungesa e pasqyrit apo përshkrimit të plotë të thënieve të dëshmitarëve apo provave të tjera të tipit deklarativ, nuk duhet të konsiderohet nga Gjykata e Apelit si shkak pavlefshmërie që ndikon në prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, por në këto raste, Gjykata e Apelit, qoftë edhe kryesisht, duhet të disponojë transkriptimin e audioverbalit, me qëllim që të formojë bindjen e saj të brendshme dhe të realizojë funksionin e dhënies së drejtësisë.

Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 16.12.2022, subjekti mbajti të njëjtin qëndrim dhe parashtrori të njëjtat shpjegime me ato të parashtruara me prapësimet e paraqitura me shkrim në lidhje me dosjet nr. 3 dhe 4.

Vlerësimi i Komisionit

Në analizë të provave të administruara dhe shpjegimeve të subjektit, duke mbajtur në konsideratë edhe vendimi nr. 5, datë 12.12.2013, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, trupi gjykues vlerësoi se shpjegimet e dhëna nga subjekti janë bindëse, mosrespektimi i afatit standard të gjykimit ka ardhur për shkaqe objektive, të pavarura nga vullneti i subjektit të rivlerësimit.

Dosja nr. 5 – kjo çështje e përfunduar me vendimin nr. *** akti, datë 25.8.2014, i përket kërkuarës: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, me objekt “vleftësimin si të ligjshëm të arrestit të shtetasit E.M”; caktimin e masës së sigurimit personal “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”, të parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, ndaj të arrestuarit E.M, i dyshuar për kryerje të veprës penale “vjedhje” e kryer në bashkëpunim, e mbetur në tentativë, e parashikuar nga nenet 134/2 dhe 22 të Kodit Penal.

Çështja është depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, në datën 23.8.2014, ora 15:30, dhe aktet i kanë kaluar gjyqtarës së gatshme Olkeda Manellari, e cila me vendimin datë 24.8.2014, ka planifikuar shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në datën 25.8.2014, ora 9:00. Seanca gjyqësore e zhvilluar në datën 25.8.2014 ka filluar në orën 10:00 (me 1 orë vonesë), është dokumentuar me procesverbal me shkrim, ku është sqaruar se për arsye të defekteve teknike në sistem, seanca nuk u regjistrua në audio. Nuk sqarohet arsyeja e fillimit me vonesë të seancës. Gjyqtarja vendosi t’i caktojë personit nën hetim avokat mbrojtës, kreu veprimet procedurale, mori në shqyrtim provat e paraqitura dhe në përfundim vendosi: *“1. Vleftësimin si të paligjshëm të arrestit në flagrancë të të arrestuarit*

E.B.M. 2. Caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues 'Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore', parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale ndaj të arrestuarit ... 3. Detyrohet i arrestuari E.B.M që në zbatim të këtij vendimi të paraqitet në Policinë Gjyqësore pranë Oficerit të Policisë Gjyqësore pranë Komisarariatit të Policisë Fier të hënën e parë të çdo muaji, ora 10:00 ...”.

Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor i dhënë nga gjyqtarja Olkeda Manellari janë dorëzuar në kryesekretarinë e gjykatës në datën 28.8.2014, pas 3 ditësh nga shpallja e vendimit, duke respektuar afatin 5-ditor të përcaktuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykimi i çështjes ka zgjatur 2 ditë, në intervalin kohor 23.8.2014 - 25.8.2014, duke respektuar afatin 48 orë të përcaktuar nga neni 259, pika 5 e Kodit të Procedurës Penale. Rrjedhimisht, subjekti i rivlerësimit ka respektuar standardin e procesit të rregullt ligjor për personat e arrestuar, të përcaktuar nga neni 28, pika 2 e Kushtetutës dhe neni 5, pika 3 e KEDNJ-së.

Është caktuar dhe zhvilluar një seancë gjyqësore, e cila ka qenë produktive, ku janë kryer veprimet procedurale për zgjidhjen e çështjes dhe në përfundim të seancës është disponuar me vendim që ka përfunduar shqyrtimin e çështjes.

Dokumentacioni në dosje është i rregullt. Në dosje ndodhen aktet e fashikullit hetimor dhe kërkesa e Prokurorisë për vleftësim arresti në flagrancë e caktim mase sigurimi, aktet e njoftimit për palët, procesverbali gjyqësor, vendimi gjyqësor përfundimtar, i cili ka marrë formë të prerë pasi nuk është ankimuar⁴⁷, etj. Procesverbali i seancës gjyqësore është i plotë, me të gjitha të dhënat dhe përshkrimet për veprimet procedurale të kryera, sipas kërkesave të neneve 345/1 dhe 346 të Kodit të Procedurës Penale. Procesverbali është i nënshkruar nga sekretarja gjyqësore dhe gjyqtari, por jo në çdo fletë, sipas përcaktimit të nenit 345/2 të Kodit të Procedurës Penale.

Gjyqtarja ka respektuar parashikimin e nenit 259/1 të Kodit të Procedurës Penale, për të zhvilluar këtë seancë me praninë e një avokati për personin e arrestuar. Gjuha e përdorur në aktet e kësaj dosjeje është normale. Mënyra e komunikimit është në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë. Nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elemente që lidhen me paanësinë e tij. Nuk ka pasur kërkesa për përjashtim të gjyqtarit. Procesverbali gjyqësor nuk është mbajtur me regjistrim në audio për arsye teknike të vetë sistemit.

KLJGJ-ja ka konstatuar se pas fjalës së prokurores që parashitroi kërkesën dhe provat nuk rezulton që fjala t'i jetë dhënë avokatit dhe personit nën hetim, të cilët e morën fjalën vetëm në konkluzionet përfundimtare dhe se kjo është në kundërshtim me parashikimin e pikës 2 të nenit 259 të Kodit të Procedurës Penale, që parashikon se: *“Prokurori tregon shkaqet e arrestimit ose të ndalimit. Pas kësaj, gjykata dëgjon të*

⁴⁷Shkresë nr. *** prot., datë 14.7.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 18.7.2022).

arrestuarin ose të ndaluarin dhe mbrojtësin ose vetëm këtë të fundit, kur i arrestuari a i ndaluari ka refuzuar të paraqitet ...”.

Dosja paraqitet e inventarizuar rregullisht dhe renditja e akteve nuk vështirëson përdorimin e saj. Vendimi paraqitet me strukturë të qëndrueshme, është i qartë dhe janë respektuar rregullat e drejtshkrimit. Ai përmban elementet e përcaktuar nga legjislacioni procedural penal dhe është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

KLJGJ-ja ka vlerësuar se vendimi i mësipërm i subjektit përmban arsyetim, por paraqet edhe mangësi në drejtim të analizës ligjore të kërkesës së prokurorit për *vleftësimin e arrestit në flagrancë ndaj shtetasit E. M.. Konstatohet se në këtë pjesë të arsyetimit, gjyqtarja është kontradiktore, pasi përfundimi i arritur nuk përputhet me faktet e konstatuara prej saj.*

Me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime për sa u konstatua më lart.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti depozitoi në Komision shpjegime të shoqëruara me dokumentacion, si vijon:

Së pari, shpjegoi se seanca gjyqësore është zhvilluar ditën e shtunë, më 25.8.2015 (me qëllim respektimin e afatit 48 orësh të shqyrtimit) dhe se përveç kësaj kërkesë të ngutshme, si gjyqtare e gatshme ajo ka shqyrtuar po atë ditë edhe kërkesa të tjera të paraqitura nga organi i akuzës dhe, për këtë shkak, seanca ka filluar një orë me vonesë⁴⁸. Gjithashtu, ka sqaruar se në kohën kur është shqyrtuar kërkesa nga komisarati të arrestuarit nuk shoqëroheshin të gjithë njëherësh, por kur kishin orarin e gjykimit dhe, për rrjedhim, i është dashur të tregojë bashkëpunim dhe koordinim me Komisaratin e Policisë dhe prokurorin e çështjes, që seanca të zhvillohej në përputhje me standardet e një procesi të rregullt ligjor.

Së dyti, lidhur me konstatimin se procesverbali nuk është nënshkruar në çdo fletë, subjekti ka shpjeguar se ky procesverbal i mbajtur me dorëshkrim është vlistuar rregullisht nga ana e saj dhe është nënshkruar në fund prej saj me cilësinë e gjyqtares, ndërsa në çdo fletë nënshkruhet nga ai që e ka mbajtur, pra sekretarja gjyqësore, sikundër neni 345/2 i Kodit të Procedurës Penale parashikonte⁴⁹. Ka vijuar shpjegimin se referuar kësaj dispozite dhe neneve 115⁵⁰ dhe 117⁵¹ të Kodit të Procedurës Penale, procesverbali i seancës gjyqësore duhet të nënshkruhet fletë më fletë nga ai që e ka përpiluar (sekretari i gjykatës), por nuk ka qenë detyrim që të nënshkruhet fletë më fletë nga gjyqtari. Ka sqaruar se ky procesverbal i numërtuar rregullisht në çdo faqe është vlistuar nga ana e saj si gjyqtare dhe është nënshkruar në fund të tij dhe se mungesa e nënshkrimit fletë më fletë nga gjyqtari, nuk

⁴⁸Kalendari elektronik i çështjeve gjyqësore për datën 25.8.2014, sipas sistemit ICMIS të gjykatës.

⁴⁹“2. Menjëherë pas mbylljes së seancës, procesverbali, i nënshkruar në fund të çdo flete nga ai që e ka mbajtur, i paraqitet kryetarit për ta vlistuar”.

⁵⁰“2. Procesverbali përpilohet nga sekretari i gjykatës, në formë të plotë ose të përmbledhur, me stenotipi, me mjet tjetër teknik dhe, kur mungojnë këto mjete, me dorëshkrim”.

⁵¹“1. Procesverbali, me përjashtim të atij që mbahet në seancën gjyqësore, pasi lexohet, nënshkruhet në fund të çdo flete nga ai që e ka përpiluar, nga ai që procedon dhe nga personat që kanë marrë pjesë”.

përbën shkak për pavlefshmërinë e tij⁵² dhe nuk sjell asnjë pasojë, pasi nënshkrimi i gjyqtarit ka për qëllim kontrollin mbi veprimet e pasqyruara nga personi që e mban procesverbalin, në këtë rast sekretari gjyqësor.

Së treti, lidhur me konstatimin e KLGJ-së *se pas fjalës së prokurores që parashtroi kërkesën dhe provat nuk rezulton që fjala t'i jetë dhënë avokatit dhe personit nën hetim*, shpjegoi se në faqen 46 të dosjes gjyqësore rezulton që pas fjalës së prokurores i ka dhënë fjalën edhe mbrojtësit dhe të arrestuarit në respektim të nenit 259/2 të Kodit të Procedurës Penale⁵³.

Së katërti, lidhur me konstatimin se arsytimi i vendimit paraqet edhe mangësi në drejtim të analizës ligjore të kërkesës së prokurorit për *“vleftësimin e arrestit në flagrancë ndaj shtetasit E. M.”* dhe se në këtë pjesë të arsytimit gjyqtarja është kontradiktore, pasi përfundimi i arritur nuk përputhet me faktet e konstatuara prej saj, subjekti ka shpjeguar se arsytimi nuk është kontradiktor, por kërkesa për vleftësimin si të ligjshëm të arrestimit në flagrancë të të arrestuarit, nuk është paraqitur brenda afatit 48-orësh nga momenti i heqjes së lirisë. Në vendimin në fjalë, ajo ka arsyetuar, ndër të tjera, se: *“Nga i gjithë materiali procedues rezulton se shtetasit e dyshuar si bashkëpunëtorë janë konstatuar nga subjekti privat dhe, më pas, kur ka arritur policia ka kryer edhe arrestimin e tyre, ngjarje këto të ndodhura midis intervalit kohor përfaqësues 12:30 - 15:00”*. Në prapësimet e depozituara në Komision, subjekti ka sqaruar: *“Pra, personave të dyshuar iu është kufizuar liria që në momentin që ata janë kapur në flagrancë në vendngjarje me sende dhe prova materiale (ora 12:30 deri 15:00). Arrestimi real rezulton të jetë kryer më herët se ora 15:00, e cila i korrespondon mbajtjes së procesverbalit të këqyrjes së vendit të ngjarjes, që në rastin konkret vjen më pas në radhën e veprimeve hetimore në momentin e flagrancës. Kështu, procesverbali i arrestimit në flagrancë nga oficeri i policisë gjyqësore në orën 22:05, nuk paraqet orën reale të kufizimit të lirisë së shtetasit. Ndërkohë që kërkesa për vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi është depozituar në gjykatë jashtë afatit 48 orësh (datë 23.8.2014, ora 15:30). Nga tërësia e akteve të administruara në dosjen gjyqësore kam vlerësuar se në plotësim të kushteve ligjore të parashikuara në dispozitat si më lart, kërkesa për vleftësimin si të ligjshëm të arrestimit në flagrancë të të arrestuarit nuk është paraqitur brenda afatit 48 orësh nga momenti i heqjes së lirisë”*.

Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 16.12.2022, subjekti mbajti të njëjtin qëndrim dhe parashtroi të njëjtat shpjegime me ato të parashtruara me prapësimet e paraqitura me shkrim, parashtruar më lart.

Vlerësimi i Komisionit

⁵²Në nenin 122 të Kodit të Procedurës Penale të kohës (pa ndryshimet e mëpasshme), përcaktohej: *“1. Procesverbali është i pavlefshëm kur ka dyshime rreth personave që kanë marrë pjesë ose kur mungon nënshkrimi i nëpunësit që e ka përpiluar”*.

⁵³*“Prokurori tregon shkaqet e arrestimit ose të ndalimit. Pas kësaj, gjykata dëgjon të arrestuarin ose të ndaluarin dhe mbrojtësin ose vetëm këtë të fundit, kur i arrestuari a i ndaluari ka refuzuar të paraqitet ...”*.

Në analizë të provave të administruara dhe shpjegimeve, trupi gjykues vlerësoi se shpjegimet e dhëna nga subjekti janë bindëse.

TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLGJ-së

1. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore për gjyqtaren Olkeda Lice (Manellari), përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk rezulton që ndaj saj të ketë ardhur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor dhe të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

2. Sipas të dhënave nga databaza e ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Olkeda Lice (Manellari) janë paraqitur gjithsej 9 ankesa (3 të vitit 2015 dhe 6 të vitit 2016) në Inspektoratin e ish KLD-së:

2.1 Pesë ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit paraprak me arsyetimin se në 3 prej tyre nuk ka rrethana dhe fakte të vlefshme për shkelje⁵⁴, dy ankesa janë të përsëritura⁵⁵.

2.2 Një ankesë e vitit 2015, e cila është informacion i kryetarit të gjykatës, verifikuar për mosrespektim të disiplinës në punë, për të është vendosur arkivimi, pasi nuk kanë rezultuar shkelje nga ana e gjyqtares.

2.3 Tri ankesa janë verifikuar dhe rezultati është si vijon:

- Një ankesë (e vitit 2016) verifikuar për zvarritje gjykimi, është vendosur evidentimi për efekt vlerësimi etik e profesional.
- Dy ankesa, ndër të cilat: (i) një depozituar në vitin 2016 (verifikuar për zvarritje hetimi, e papërfunduar) – me krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kjo praktikë i është dërguar për kompetencë këtij institucioni; (ii) për një ankesë të vitit 2016 (e njëjta ankesë ardhur nga presidenca), është propozuar bashkimi me ankesën e dorëzuar tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

3. Komisioni kërkoi informacion⁵⁶ nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë nëse pranë këtij institucioni janë përcjellë ankesa dhe ky i fundit na informoi⁵⁷ se pranë këtij institucioni, ndaj gjyqtares Olkeda Lice (dhe disa magjistratëve të tjerë), janë depozituar ankesa nga 10 persona⁵⁸. Disa prej ankuesve kanë depozituar disa ankesa, të cilat u referoheshin të njëjtave fakte dhe drejtoheshin ndaj të njëjtëve magjistratë, prandaj është vendosur bashkimi dhe trajtimi i përbashkët i tyre në të njëjtin akt.

Në përfundim të shqyrtimit të tyre, ILD-ja për disa prej tyre ka vendosur arkivimin, ndërsa të tjerat janë në fazën e shqyrtimit fillestar.

ANALIZA E GJETJEVE

⁵⁴Një e vitit 2015, dy të vitit 2016.

⁵⁵Ndër të cilat një ankesë e vitit 2015, ardhur nga Ministria e Drejtësisë dhe një ankesë e vitit 2016.

⁵⁶Shkresë nr. *** prot., datë 30.6.2022.

⁵⁷Shkresë nr. *** prot., datë 13.9.2022 (*** prot., datë 14.9.2022).

⁵⁸Regjistruar në ILD në vitet 2020, 2021 dhe 2022.

Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; si dhe (iii) të dhënave nga burimet arkivore në KLGJ.

Subjekti është vlerësuar pozitivisht për aftësitë profesionale, si vijon:

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit ka shfaqur aftësi shumë të mira në drejtim të identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Subjekti ka gjykuar si çështje penale themeli, ashtu edhe çështje civile me palë kundërshtare. Në gjykimet penale është konstatuar se gjyqtarja njih dhe zbaton mjaft mirë legjislacionin penal dhe procedural penal dhe bën referenca në Jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë, por edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së. Në çështjet civile është konstatuar se gjyqtarja analizon bazën ligjore të padisë, por përfshin në analizë edhe dispozita të tjera ligjore në kuadër të zgjidhjes së drejtë të çështjes. Dispozita ligjore citohet dhe analizohet në raport me faktet e pretenduara nga palët dhe nuk mungojnë referencat në vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, kur është rasti.

b) Arsytimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit ka shfaqur aftësi shumë të mira në arsyetimin ligjor, si në vendimet që i përkasin çështjeve penale, ashtu edhe në vendimet që ju përkasin çështjeve civile. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj janë të qarta, të kuptueshme, qëndrimi i mbajtur lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes jepet i argumentuar, provat e marra në shqyrtim jo vetëm citohen, por edhe tregohet se çfarë u provua me përmbajtjen e tyre. Niveli i arsyetimit të vendimeve respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Respektohen rregullat e drejtshkrimit dhe përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura e vendimit është e qëndrueshme, e mirorganizuar dhe e standardizuar.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit Olkeda Lice (Manellari), në periudhën 8.10.2013 - 23.1.2014, nuk ka gjykuar çështje, pasi ishte në pritje të emërimit përfundimtar si gjyqtare pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës. Në datën 23.1.2014, znj. Olkeda Manellari është emëruar përfundimisht gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Ajo ka deklaruar në formularin e vetëvlerësimit profesional se gjatë periudhës 23.1.2014 - 29.2.2016 i janë caktuar për gjykim gjithsej 1058 çështje, ku ka përfunduar 892 çështje, duke mbartur vitin e fundit 349 çështje. Rendimenti i përfundimit të çështjeve,

bazuar në këto të dhëna është 92.8%. Gjyqtarja deklaroi se në periudhën 1.3.2016 - 3.1.2017 ka qenë me leje lindje.

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, gjyqtarja Olkeda Manellari ka përfunduar së gjykuari 884 çështje⁵⁹.

Në lidhje me mosrespektimin e afatit standard të gjykimit për çështjet e trajtuara më lart, sikurse u analizua, Komisioni konkludoi që kjo ka ndodhur për shkaqe objektive, prandaj nuk mund të konsiderohen shkaqe të mjaftueshme për të konkluduar që subjekti është joeficient.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit Olkeda Manellari ka shfaqur aftësi shumë të mira për të kryer procedurat gjyqësore dhe i kushton vëmendje zhvillimit të seancave gjyqësore në funksion të solemnitetit dhe transparencës së gjykimit.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short për gjyqtaren Olkeda Lice (Manellari) nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale. Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit. Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara janë inventarizuar aktet procedurale.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës Olkeda Manellari⁶⁰. Edhe nga vëzhgimi i pesë dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Olkeda Manellari dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e subjektit ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Gjatë periudhës 8.10.2013 – 8.10.2016, në adresë të gjyqtarës Olkeda Manellari në ish-Inspektoratin e KLD-së, nuk është depozituar asnjë ankesë në lidhje me integritetin e saj.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Olkeda Manellari.

⁵⁹Nga ky total, 145 janë çështje civile të përgjithshme, 161 penale themeli, 181 janë penale masa sigurimi, 242 janë kërkesa penale dhe 152 çështje janë kërkesa civile.

⁶⁰Shihni të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së.

Dy pretendime për konflikt interesi të gjyqtarës Olkeda Manellari, të paraqitura si ankesë në ish-Inspektoratin e KLD-së, pas verifikimit të tyre rezultuan të pabazuara. Për vetë gjyqtarën Manellari, në asnjë nga pesë dosjet e vëzhguara nuk ka pasur kërkesë për përjashtimin e saj nga gjykimi. Nga ana tjetër, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Në të tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e tjera të vëzhguara nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit Olkeda Manellari nuk ka respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara në procesverbalet gjyqësore, por edhe në regjistrimin e seancave në audio është konstatuar se komunikimi i gjyqtarës me palët është në përputhje me etikën e gjyqtarit dhe i qartë, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e gjyqtarës Olkeda Manellari, për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Nga analiza e pesë dosjeve të shortuara nuk hasen problematika në bashkëpunimin e subjektit të rivlerësimit me stafin administrativ të gjykatës.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Rezulton se subjekti Olkeda Manellari ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh të organizuar pranë dhe jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, të cilat janë përshkruar më sipër, si dhe studime të tjera jashtë Shkollës së Magjistraturës⁶¹.

LIDHUR ME NJË KONSTATIM TË KOMISIONIT

1. Nga hetimi i Komisionit për efekt të ekzistencës së ndonjë konflikti të mundshëm interesi të subjektit me personat me të cilët ka kryer veprime juridike, rezultoi se⁶² subjekti ka shqyrtuar dy çështje penale ku palë ka qenë z. G.R, me të cilin subjekti kishte lidhur kontratën informale të qirasë për apartamentin e marrë me qira nga subjekti, për periudhën 15.2.2018 - 14.1.2019, kundrejt qirasë 15.000 lekë/muaj.

⁶¹Studimet *Master* pranë U.F.O.A., duke marrë diplomën “Master i Nivelit të Dytë në Shkenca Administrative”, si dhe ka përfunduar universitetin veror të organizuar nga Fondation ***, Civil Law Initiative, duke u diplomuar me diplomën “Continental Law Summer University”. Gjithashtu, ka mbrojtur me diplomë gjuhën italiane dhe atë angleze pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës.

⁶²Shkresë nr. *** prot., datë 30.3.2022 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 1.4.2022).

1.1 Njëra çështje është çuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, me të pandehur G.R dhe viktimë A.B, akuzuar secili për kryerjen e veprës penale “plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal. Kjo çështje është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier në datën 13.4.2021 dhe është gjykuar nga subjekti i rivlerësimit Olkeda Manellari, e cila në përfundim ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes penale në fjalë, për shkak se viktima hoqi dorë nga ankimi.

1.2 Çështja tjetër është kërkesa penale e çuar në gjykatë nga viktima akuzuese G.R ndaj të akuzuarit A.B, për veprën penale “dëmtime të tjera me dashje”, parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal. Çështja është regjistruar në gjykatë në datën 26.3.2021 dhe është shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit, i cili në zbatim të nenit 338 të Kodit të Procedurës Penale u ka propozuar palëve zgjidhjen e çështjes me pajtim. Në kushtet kur palët e kanë zgjidhur çështjen me pajtim, gjykata (subjekti) ka vendosur pushimin e gjykimit.

1.3 Të dyja vendimet janë marrë në datën 5.7.2021. Marrëdhënia e qirasë midis subjektit dhe qiradhënësit G.R ka zgjatur nga data 15.2.2018 deri më 14.1.2019. Në datën 14.10.2020 subjekti dhe qiradhënësi kanë bërë deklaratë noteriale ku kanë deklaruar marrëdhënien informale të qirasë për periudhën e mësipërme.

1.4 Komisioni vlerësoi se bazuar në nenin 17 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti duhet të hiqte dorë nga gjykimi i këtyre çështjeve, ku i pandehur dhe viktimë akuzuese ishte një person me të cilin ajo ka pasur marrëdhënie kontraktuale dhe se kjo përbën një shkelje të etikës profesionale nga ana e subjektit të rivlerësimit.

1.5 Me dërgimin e rezultateve të hetimit sipas pikës 2 të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e hetimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

1.6 Pas dërgimit të rezultateve të hetimit me të cilat iu kalua barra e provës, subjekti depozitoi në Komision shpjegimet si vijon: *“Së pari në dy çështjet e referuara, ku palë në cilësinë respektivisht të të pandehurit dhe viktimës akuzuese ka qenë ish-qiradhënësi im, theksoj se nuk janë prezente asnjë nga situatat ligjore që përlligjin kërkesën për heqje dorë nga gjykimi, parashikuar nga neni 17, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale. Ekzistenca e marrëdhënieve kontraktuale me palët në procedim përcaktohet si shkak ligjor për heqjen dorë në shkronjën a) të nenit 17, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale ku parashikohet se: ‘1. Gjyqtari ka për detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete: a) kur ka interes në procedim ose kur një nga palët private ose një mbrojtës është debitor a kreditor i tij, i bashkëshortit, bashkëjetuesit ose i fëmijëve të tij’.*

Në rastin konkret më lejoni të shpjegoj se:

- a) *marrëdhënia ime, në cilësinë e qiramarrësit, në raport me shtetasin G.R, në cilësinë e qiradhënësit, nuk vlerësoj se ka qenë një marrëdhënie kredie apo debie, por një marrëdhënie kontraktuale në bazë të së cilës unë kam pasur të drejtën e banimit dhe*

po ashtu kam përmbushur me korrektësi detyrimet që burojnë nga marrëdhënia kontraktore e qirasë;

- b) *neni 17, pika 1, shkronja a) referon për ekzistencën e një situate që passjell vendosjen e palëve në pozitën e kreditorit ose debitorit, e cila duhet të ketë aktualitet, pra të ekzistojë në momentin që paraqitet çështja për gjykim, duke përligjur në këtë mënyrë ekzistencën e rastit në të cilin gjyqtari duhet të heqë dorë nga gjykimi i çështjes. Në rastin konkret, marrëdhënia ime e qirasë me palën rezulton se kishte përfunduar prej datës 14.1.2019 dhe pas përfundimit të kësaj marrëdhënieje, asnjë prej nesh nuk ka qenë në raportet e debitorit apo kreditorit kundrejt njëri-tjetrit.*

.... në raport me institutin procedural të heqjes dorë nga gjykimi, vlerësoj se kam treguar vëmendje maksimale për të hequr dorë nga gjykimi i çështjeve, në të cilat kam qenë në kushtet e papajtueshmërisë për të gjykuar sipas parashikimeve të neneve 15 dhe 16 të Kodit të Procedurës Penale apo në situatat në të cilat mund të jenë paraqitur rrethanat ligjore dhe faktike të heqjes dorë sipas parashikimeve të nenit 17 të Kodit të Procedurës Penale. Por, nga ana tjetër, nuk e kam përdorur asnjëherë këtë mjet procedural për të krijuar situatë artificiale konflikti me qëllim shmangien nga gjykimi i çështjeve, e cila sërish vlerësohet si shkelje etike nga ana e gjyqtarit që e bën të shpeshtë. Në praktikën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, por jo vetëm ..., ka pasur raste të ngjashme ku gjyqtari ka pasur një marrëdhënie kontraktuale të përfunduar me një nga palët në procesin që po gjykonte dhe kërkesa e tij për heqje dorë nuk është pranuar; ose kur gjyqtari ka qenë në marrëdhënie pune më herët se fillimi i detyrës me një nga palët dhe sërish kjo kërkesë nuk është pranuar; gjyqtari ka hequr dorë pasi një familjar i tij ka qenë në marrëdhënie aktuale pune me një nga palët në proces dhe sërish kërkesa nuk është pranuar⁶³. KLGJ-ja, në vlerësimin e vet, por edhe në arkivin e saj nuk ka konstatuar asnjë rast ku unë kam gjykuar në konflikt interesi. Në këtë këndvështrim, më lejoni të theksoj që në kushtet kur në kohën që më janë caktuar të dy çështjet e referuara, nuk kam pasur asnjë marrëdhënie apo kontakt me ish-qiradhënësin tim, nuk kam pasur me të asnjë marrëdhënie kredie apo debie, nuk kam pasur asnjë raport kontraktual ose jokontraktual në atë moment, ekzistenca e të cilit do të më vendoste në kushtet e heqjes dorë nga gjykimi i çështjeve. Në këtë drejtim e gjej me vend të theksoj se, edhe në kohën që është krijuar dhe zhvilluar kjo marrëdhënie qiraje mes nesh, marrëdhëniet me qiradhënësin kanë qenë korrekte dhe unë kam përmbushur çdo detyrim që buronte nga kontrata e qirasë ...”.

Në vijim, subjekti ka sqaruar se kjo marrëdhënie qiraje, që në momentin e gjetjes së banesës dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj, nuk është zhvilluar mbi bazën e kontakteve të drejtpërdrejta midis saj dhe qiradhënësit, por është krijuar me ndërmjetësimin dhe ndihmën e të afërmeve dhe motrës së saj dhe se edhe pagesat mujore të qirasë nga ana e saj janë kryer nëpërmjet tyre, kjo për shkak të impenjimit të saj në punë dhe sjelljes së rezervuar në shoqëri. Ka sqaruar se në kuadër të procesit të *Vettingut* dhe nevojës për të pasur të dokumentuar marrëdhëniet me pronarët e banesave ku ka deklaruar se ka jetuar me qira,

⁶³Bashkëlidhur ka vendosur dokumentacionin.

sërisht nëpërmjet motrës së saj ka kontaktuar me z. G.R në vitin 2020 dhe në datën 14.10.2020 kanë nënshkruar deklaratën noteriale të depozituar pranë Komisionit me përgjigjet e pyetësorit standard dhe se asnjëherë nuk ka pasur raporte të drejtpërdrejta me të dhe nuk ka qenë në pozitat e kreditorit apo debitorit pas përfundimit të marrëdhënies së qirasë në datën 14.1.2019.

Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se dy çështjet penale të trajtuara prej saj “ *i referoheshin të njëjtit fakt penal ku shtetasi G.R dhe shtetasi A.B kishin pasur një konflikt të pretenduar fizik mes tyre. Them të pretenduar, pasi fakti penal as nuk u mor në shqyrtim themeli dhe as nuk jam shprehur me vendim lidhur me ekzistencën e faktit. Në seancën kur këta shtetas u paraqitën personalisht, i bënë me dije gjykatës se duke qenë se çështjet në ngarkim të tyre ishin reciproke, marrëdhënien mes tyre e kishin zgjidhur me pajtim dhe bazuar në nenin 284 dhe 388 të Kodit të Procedurës Penale në të dyja çështjet gjykimi u pushua për efekt procedural. Pikërisht, fakti që gjykimet përfunduan shumë shpejt dhe për shkak se u pushuan, kjo mund të më ketë ndikuar që të mos ua bëj prezent palëve situatën e mëparshme të marrëdhënies kontraktuale, që kisha pasur me njërin prej tyre, e cila sikurse shpjegova më sipër, ishte vlerësuar nga unë se nuk përbënte shkak për heqje dorë nga gjykimi referuar edhe gjithë praktikës së mbajtur nga kryetari i gjykatës⁶⁴ ... Duke vlerësuar në tërësi sa më sipër, në raport me parashikimet e nenit 17, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, vlerësoj se në rastin konkret nuk jemi para situatës së heqjes dorë nga gjykimi i çështjeve të referuara, pasi nuk rezulton asnjë marrëdhënie aktuale (në raport me momentin e gjykimit të çështjeve) apo e afërt e cila vendos gjyqtarin në raporte kredie apo debie me palët apo përfaqësuesit e tyre”.*

1.7 Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 16.12.2022, subjekti mbajti të njëjtin qëndrim dhe parashtrori të njëjtat shpjegime me ato të parashtruara me prapësimet e paraqitura me shkrim.

Vlerësimi i Komisionit

1.8 Për të vlerësuar nëse subjekti ka gjykuar në kushtet e konfliktit të interesit, trupi gjykues mori në konsideratë përcaktimet që ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” bën për konfliktin e interesit. Sipas pikës 4 të nenit 3 të këtij ligji: “*a) ‘konflikt faktik i interesit’ është gjendja në të cilën interesat privatë të zyrtarit ndikojnë, kanë ndikuar ose mund të kenë ndikuar në kryerjen*

⁶⁴Dokumentacion i depozituar nga subjekti bashkëlidhur prapësimeve: shkresa heqje dorë nr. *** prot., datë 29.6.2020; shkresa heqje dorë nr. *** prot., datë 29.6.2020; vendim për shqyrtimin e kërkesës për dorëheqje nr. ***, datë 2.7.2020; vendim për shqyrtimin e kërkesës për dorëheqje nr. ***, datë 2.7.2020; vendim për shqyrtimin e kërkesës për dorëheqje nr. ***, datë 2.7.2020; kërkesë për heqje dorë nr. *** prot., datë 2.7.2020; vendim për shqyrtimin e kërkesës për dorëheqje nr. ***, datë 3.7.2020; kërkesë për heqje dorë nr. *** prot., datë 7.12.2021; kërkesë për heqje dorë nr. *** prot., datë 7.12.2021; kërkesë për heqje dorë nr. *** prot., datë 7.12.2021; kërkesë për heqje dorë nr. *** prot., datë 7.12.2021; vendim për shqyrtimin e kërkesës për dorëheqje nr. ***, datë 9.12.2021; vendim për shqyrtimin e kërkesës për dorëheqje nr. ***, datë 9.12.2021; vendim për shqyrtimin e kërkesës për dorëheqje nr. ***, datë 9.12.2021; vendim për shqyrtimin e kërkesës për dorëheqje nr. ***, datë 9.12.2021; vendim për shqyrtimin e kërkesës për dorëheqje nr. ***, datë 27.10.2022; kërkesë për heqje dorë datë 1.2.2021; vendim për shqyrtimin e kërkesës për dorëheqje nr. ***, datë 2.2.2021; kërkesë për heqje dorë nr. ***, datë 19.10.2022; vendim për shqyrtimin e kërkesës për dorëheqje nr. ***, datë 24.10.2022; kërkesë kryetares së Gjykatës së Apelit Vlorë, datë 18.7.2022, nr. *** prot. dhe vendimi i zv/kryetares+vendimi nr. ***, datë 2.11.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij zyrtare; b) 'konflikt në dukje i interesit' është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësive të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë; c) 'konflikt i mundshëm i interesit' është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit mund të shkaktojnë në të ardhmen shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje të interesit, nëse zyrtari do të përfshihej në detyra apo përgjegjësi të caktuara.

Në nenin 5 të këtij ligji, përcaktohet se: *"1. Interesat private të zyrtarit janë ato interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga: a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre; b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile; 4. Vlerësohet shkak për lindjen e konfliktit të interesit, çdolloj interesi privat i një zyrtari nga ata të përcaktuar në këtë nen, çdo lidhje apo gërshetim ndërmjet dy a më shumë prej tyre, nëse për shkak të këtij interesi ose për shkak të daljes jashtë kufizimeve të detyrueshme të këtij interesi shfaqet një gjendje me konflikt interesi, sipas përkufizimeve të pikave 1 e 4 të nenit 3 të këtij ligji".*

Trupi gjykues solli në vëmendje faktin që marrëdhënia e qirasë midis subjektit dhe qiradhënësit, z. G.R, ka zgjatur nga data 15.2.2018 deri më 14.1.2019, deklarata noteriale ku subjekti dhe z. G.R, për efekt të plotësisimit të dokumentacionit për procesin e rivlerësimit, kanë deklaruar marrëdhënien informale të qirasë për periudhën e mësipërme, është bërë në datën 14.10.2020, ndërsa dy vendimet ku është i përfshirë ish-qiradhënësi janë dhënë nga ana e subjektit në datën 5.7.2021, Pra, në kohën e vendimmarrjes, midis subjektit dhe ish-qiradhënësit nuk ekzistonte më asnjë marrëdhënie juridike, pasi kontrata e qirasë i kishte përfunduar efektet e saj dhe, gjithashtu, nuk u provua ekzistenca e ndonjë marrëdhënieje detyrimi midis tyre pas përfundimit të kësaj marrëdhënieje.

Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se nuk gjendet para rasteve të sipërcituara të përcaktuara në nenin 5 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, pasi në kohën e vendimmarrjes, midis palëve nuk ekzistonte asnjë marrëdhënie juridiko-civile dhe nuk u provua ekzistenca e të drejtave dhe detyrimeve pasurore të çfarëdolloji midis tyre. Gjithashtu, duke mos qenë në kushtet kur midis tyre ka një marrëdhënie detyrimi apo interesi, trupi gjykues nuk gjendet as para rasteve të përcaktuara në nenin 17 të Kodit të Procedurës Penale, kur gjyqtari ka për detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes, nuk gjendet as para rastit kur gjyqtari ka interes në procedim ose kur pala është debitor a kreditor i tij (germa "a") dhe as para rastit kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie (germa "ë").

Përveç fakteve sa më lart, në kryerjen e kësaj analize trupi gjykues mbajti parasysh edhe faktin që çështjet e shqyrtuara nga subjekti ishin rrjedhojë e një konflikti midis shtetasve G.R dhe A.B, të cilin ata e kishin zgjidhur me pajtim, duke ia bërë me dije gjykatës këtë fakt dhe, në këto kushte, gjykata (subjekti) ka vendosur pushimin e gjykimit, pa u shprehur me vendim në lidhje me ekzistencën e faktit penal.

1.8 Në analizë të provave të administruara dhe shpjegimeve, trupi gjykues vlerësoi se subjekti, në këtë vendimmarrje, nuk ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit.

Rivlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni

Komisioni, me qëllim vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet penale të përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Pas verifikimit të raportit, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me vlerësimin profesional.

DENONCIME

Ndaj subjektit të rivlerësimit janë depozituar në Komision 4 denoncime. Pasi shqyrtoi secilin prej tyre, trupi gjykues administroi dosjet e proceseve gjyqësore, shqyrtoi dokumentacionin e administruar në dosje dhe regjistrimet audio, analizoi me objektivitet dokumentacionin si më lart dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit dhe pas dërgimit të rezultateve të hetimit në lidhje me këto denoncime.

1. Denoncimi nr. * prot., datë 20.9.2019, nga shtetasi S.M**

Denoncuesi, në cilësinë e viktimës, ka paraqitur një kallëzim penal pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ndaj shtetasit K.DH. Pas kryerjes së hetimeve, kjo prokurori ka kërkuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier pushimin e çështjes dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier (gjyqtare Olkeda Lice (Manellari) ka vendosur *“Pranimin e kërkesës. Pushimin e çështjes penale nr. *** procedimi, datë regjistrimi 31.12.2014 për veprën penale ‘falsifikim i dokumenteve’, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal”*.

Ky vendim nuk është ankimuar nga palët dhe ka marrë formë të prerë në datën 21.12.2019⁶⁵.

Në Komision denoncuesi ka parashtruar pretendime për sjellje joetike të gjyqtarës gjatë seancave gjyqësore dhe për njëanshmëri të saj, duke mbështetur të kallëzuarin.

Komisioni administroi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier⁶⁶ dosjen gjyqësore dhe regjistrimet audio të seancave. Nga procesverbalet e seancave gjyqësore dhe nga regjistrimet audio të seancave, rezultoi se gjuha e përdorur nga subjekti është normale, në përputhje me etikën gjyqësore dhe e qartë. Nuk vërehet njëanshmëri e subjektit, sjellja e tij është korrekte, me gjithë vështirësitë për shkak të mungesës së njohurive juridike të viktimës S.M, i cili pavarësisht se gjyqtarja i ofroi t’i vendoste në dispozicion mbrojtës, nuk pranoi duke deklaruar se nuk ka besim tek avokatët shqiptarë. Subjekti nuk përdor gjuhë fyese apo diskriminuese për palët dhe është shprehur në lidhje me të gjitha kërkesat e viktimës S.M në proces.

Në përfundim, trupi gjykues konkludoi që nuk rezultuan sjellje joetike apo njëanshmëri e gjyqtarës. Gjithashtu, ndaj vendimit të mosfillimit nuk ka pasur ankim, çka do të thotë që denoncuesi nuk e ka ushtruar të drejtën e tij ligjore për të bërë ankim ndaj këtij vendimi.

⁶⁵Shkresë nr. *** prot., datë 23.6.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 28.6.2022) dhe shënimi në vendim.

⁶⁶Shkresë nr. *** prot., datë 8.6.2021 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 10.6.2022).

2. Denoncimi nr. * prot., datë 9.6.2021, nga shtetasi A.R**

Denoncimi përmbante pretendime të përgjithshme lidhur me pasurinë, figurën dhe profesionalizmin e subjektit të rivlerësimit Olkeda Lice (Manellari), por pa asnjë të dhënë konkrete apo dokumentacion shoqërues.

2.1 Në këto kushte, me qëllim hetimin në lidhje me sa ishte parashtruar në mënyrë të përgjithshme në këtë denoncim, Komisioni kontaktoi me telefon me denoncuesin në numrin e dhënë prej tij⁶⁷, duke i kërkuar që të përcjellë pranë Komisionit informacion konkret ose çdo dokumentacion që mund të disponojë. Denoncuesi u përgjigj se nuk e ka bërë ai denoncimin.

2.2 Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se nuk ka *indicie* për të hetuar më tej në lidhje me këto pretendime.

3. Denoncimi nr. * prot., datë 11.2.2022, nga shtetasi A.L**

Denoncuesi ka parashtruar pretendime të përgjithshme, të njëjta si denoncimi i mësipërm, lidhur me pasurinë, figurën dhe profesionalizmin e subjektit të rivlerësimit, por pa asnjë të dhënë konkrete apo dokumentacion shoqërues, si dhe ka pretenduar se “*emri i saj është përmendur edhe nga ministra si gjyqtare abuzuese*”.

3.1 Në lidhje me pretendimet e përgjithshme dhe pa asnjë të dhënë konkrete, Komisioni kontaktoi me denoncuesin në adresën elektronike të lënë prej tij në denoncim, duke i kërkuar që të përcjellë informacion konkret ose çdo dokumentacion që mund të disponojë. Denoncuesi u përgjigj po në rrugë elektronike që nuk ka bërë asnjë ankesë për zonzjen⁶⁸.

3.2 Në lidhje me pretendimin se emri i saj është përmendur nga ministra si gjyqtare abuzuese, nga hetimi rezultoi se ministri i Brendshëm i kohës (S.T) i ka dërguar një letër Presidentit të Republikës, duke i paraqitur disa raste të vendimeve të gjykatave dhe prokurorisë, të cilat rezultojnë me shkelje, duke i kërkuar atij ndëshkim të këtyre gjyqtarëve që kanë marrë këto vendime. Një ndër gjyqtarët e përmendur në këtë shkrim është subjekti i rivlerësimit Olkeda Manellari, për të cilën është parashtruar se ka vendosur masën e sigurimit “arrest në shtëpi” për shtetasit B. Ç. dhe H. L. dhe “detyrim paraqitjeje për shtetasen F. H.”, ndërkohë që prokurorja e çështjes për këta 3 të arrestuar në flagrancë ka kërkuar masën e sigurimit “arrest në burg”.

3.2.1 Komisioni administroi dosjet përkatëse në lidhje me këto procedime⁶⁹, nga të cilat rezultoi se shtetasit F.H dhe B.Ç janë arrestuar si të dyshuar për veprën penale “prostitucion”, parashikuar nga neni 113/1 i Kodit Penal, ndërsa shtetasi H.L është arrestuar si i dyshuar për veprën penale “shfrytëzim prostitucioni” dhe “mbajtje e lokaleve për prostitucion”, të parashikuara nga nenet 114/2 dhe 115 të Kodit Penal.

⁶⁷Adresa e *email*-it e lënë prej tij rezultoi jo e saktë.

⁶⁸*Email* datë 3.11.2022.

⁶⁹Shkresë nr. *** prot., datë 5.7.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 8.7.2022 dhe nr. *** prot., datë 8.7.2022).

3.2.2 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka kërkuar pranë kësaj gjykate vleftësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë për këta shtetas dhe caktimin ndaj tyre të masës së sigurimit personal “arrest në burg”.

3.2.3 Këto kërkesa penale janë shqyrtuar nga gjyqtarja subjekt rivlerësimi, znj. Olkeda Manellari, e cila ka vleftësuar si të ligjshëm arrestin e të arrestuarve në fjalë. Në lidhje me masën e sigurimit personal ka vendosur caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi” për shtetasit B.Ç⁷⁰ dhe H.L⁷¹ dhe masën e sigurimit “detyrim paraqitjeje në policinë gjyqësore” për shtetasen F.H⁷².

3.2.4 Këto vendime janë ankimuar nga prokurori dhe Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur miratimin e vendimeve të sipërpërmendura lidhur me vleftësimin e ligjshëm të arrestit, ndërsa lidhur me masat e sigurimit personal, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur:

- Ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 23.9.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë në këtë mënyrë: “Caktimin ndaj të dyshuarit B.Ç të masës së sigurimit të parashikuar nga neni 236 i Kodit të Procedurës Penale ‘garanci pasurore’, në masën 200.000 lekë”⁷³.
- Ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 23.9.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë në këtë mënyrë: “Caktimin e masës së sigurimit ‘arrest në burg’ ndaj shtetasit H.L”⁷⁴.

Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e këtij vendimi sa i përket masës së sigurimit për shtetasin H.L dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier sa i përket caktimit të masës së sigurimit ndaj këtij shtetasi⁷⁵:

- Miratimin e vendimit nr. ***, datë 23.9.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier lidhur me shtetasen F.H⁷⁶.

Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të bërë ndaj këtij vendimi nga prokurori pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.

3.2.5 Komisioni konstatoi se vendimi i subjektit është ndryshuar nga Gjykata e Apelit dhe i kërkoi subjektit të japë shpjegime se cilat ishin argumentet ligjore ku është bazuar në caktimin e masës së sigurimit si më lart.

3.2.6 Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti depozitoi në Komision parashtrimet e tij, duke shpjeguar fillimisht se masa e sigurimit personal nuk është dënim penal që të përdoret si masë ndëshkimore dhe nuk është përcaktuese në fajësinë ose jo të të ndaluarit, por ajo vendoset kur ekzistojnë të gjitha elementet objektive dhe subjektive të parashikuara

⁷⁰Vendimi nr. ***, datë 23.9.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

⁷¹Vendimi nr. ****, datë 23.9.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

⁷²Vendimi nr. ***, datë 23.9.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

⁷³Vendimi nr. ***, datë 6.11.2014, i Gjykatës së Apelit Vlorë.

⁷⁴Vendimi nr. ***, datë 28.10.2014, i Gjykatës së Apelit Vlorë.

⁷⁵Vendimi nr. ***, datë 25.2.2015, i Gjykatës së Lartë.

⁷⁶Vendim nr. ***, datë 6.11.2014, i Gjykatës së Apelit Vlorë.

nga nenet 228/1/2/3, germat “a”, “b” dhe “c”⁷⁷, si dhe nenet 229/1/2⁷⁸ dhe 230/1⁷⁹ të Kodit të Procedurës Penale, në funksion të zbulimit të së vërtetës dhe vënien para përgjegjësisë së autorëve të veprës penale. Subjekti ka vijuar arsyetimin se fakti që të gjithë këta shtetas janë dënuar me vendim përfundimtar të gjykatës duke marrë llojin dhe masën e caktuar të dënimit, ka treguar se masat e sigurimit të caktuara nga ana e saj jo vetëm që nuk kanë penguar zbulimin e së vërtetës, por as nuk kanë ndikuar në shmangien e autorëve ndaj ndjekjes penale ose kryerjen e veprave të tjera penale⁸⁰.

Subjekti ka shpjeguar se në caktimin e masave të sigurisë ka mbajtur parasysh kushtet specifike të të dyshuarve dhe ka marrë në analizë paragrafët 2 dhe 3 të nenit 230 të Kodit të Procedurës Penale⁸¹. Për shtetasin H.L ka mbajtur parasysh moshën e tij mbi 70 vjeç, faktin që vuante nga diabeti, që ishte i padënuar, etj. dhe ka sjellë në vëmendje faktin që Gjykata e Lartë ka vendosur⁸² lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për sa i përket caktimit të masës së sigurimit ndaj këtij shtetasi.

Për shtetasin B. Ç. ka sqaruar se përveç natyrës së veprës penale dhe marzheve të ulëta të dënimit ka mbajtur parasysh edhe rrethanat lehtësuese, moshën e tij, faktin që personi para gjykatës u shfaq i penduar, shumë i rënduar psikologjikisht, faktin që nuk ka precedentë të mëparshëm penalë, si dhe faktin që është kryefamiljar. Gjithashtu, ka theksuar se Gjykata e Apelit ka lehtësuar masën e sigurimit të caktuar prej saj, duke caktuar “garanci pasurore”, parashikuar nga neni 236 i Kodit të Procedurës Penale, ndërkohë ky vendim rezultoi të mos jetë rekursuar nga prokuroria, pavarësisht se ajo kishte kërkuar masën e sigurimit “arrest në burg”.

Për shtetasin F.H subjekti ka sqaruar se ka mbajtur parasysh faktin që ka qenë rreth 47 vjeçe, e padënuar më parë, në kushte shumë të vështira ekonomike, nënë e tre fëmijëve – dy prej të cilëve të mitur, e cila shfaqti gjatë marrjes në pyetje një gjendje të rënduar emocionale dhe psikologjike dhe se të gjitha këto rrethana janë vlerësuar prej saj (subjektit) se e ndaluar nuk ka shfaqur një rrezikshmëri shoqërore të veçantë, sa të caktohet si masë ekstreme “arrest në burg”.

3.3 Në analizë të provave të administruara dhe shpjegimeve, trupi gjykues vlerësoi se shpjegimet e dhëna nga subjekti janë bindëse.

⁷⁷Neni 228, kushtet për caktimin e masave të sigurimit personal: “1. Askush nuk mund t’u nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova. 2. Asnjë masë nuk mund të zbatohet kur ka shkaqe padënueshmërie ose të shuarjes së veprës penale. 3. Masat e sigurimit personal vendosen: a) kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës; b) kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet; c) kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet”.

⁷⁸“1. Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret. 2. Çdo masë duhet të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Mbahen parasysh edhe vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga Kodi Penal”.

⁷⁹“1. Arresti në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit”.

⁸⁰Vendimi nr. ***, datë 11.1.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe vendimi nr. ***, datë 31.3.2016, i Gjykatës së Apelit Vlorë.

⁸¹“2. Nuk mund të vendoset arresti në burg ndaj një gruaje që është shtatzënë ose me fëmijë në gji, ndaj një personi që ndodhet në gjendje shëndetësore veçanërisht të rëndë ose që ka kaluar moshën shtatëdhjetë vjeç ose një personi toksikoman apo të alkoolizuar, për të cilin zbatohet një program terapeutik në një institucion të posaçëm. 3. Në rastet e parashikuara në pikën 2 arresti në burg mund të vendoset vetëm kur ka shkaqe të një rëndësie të veçantë për krimet që dënohen jo më pak në maksimum se dhjetë vjet burgim”.

⁸²Vendimi nr. ***, datë 25.2.2015.

3.4 Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 16.12.2022, subjekti mbajti të njëjtin qëndrim dhe parashtrori të njëjtat shpjegime me ato të parashtruara me propësimet e paraqitura me shkrim.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Olkeda Lice ka plotësuar së bashku kushtet si vijon:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Olkeda Lice, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 19.12.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleda ÇIFTJA
Kryesuese

Alma FASKAJ
Relatore

Suela ZHEGU
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Albana Plaka